



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E ARSIMIT PARASHKOLLOR

(Moshë 5-6 vjeç)



Tiranë

2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 8376/1 Prot.

Tiranë, më 16 09: 2019

URDHËR

Nr. 455, datë 16.09.2019

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMEVE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR
(MOSHA 5-6 VJEÇ)

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 2, pika 24 dhe nenit 27/1 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programeve të arsimit parashkollor (mosha 5-6 vjeç)”, bashkëlidhur.
2. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

BESA SHAHINI



TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	2
HYRJE	6
FUSHA “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”	8
PROGRAMI I LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE	8
1.1 Hyrje.....	8
1.2 Përmbajtja lëndore.....	10
1.2.1 Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	10
1.2.2 Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	12
1.2.3 Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.....	15
1.2.4 Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.....	18
1.3 Materialet dhe burimet mësimore	21
FUSHA E MATEMATIKËS.....	22
PROGRAMI I MATEMATIKËS	22
2.1 Hyrje.....	22
2.2 Përmbajtja lëndore.....	26
2.2.1 Tematika: Numri.....	26
2.2.2 Tematika: Matja	30
2.2.3 Tematika: Gjeometria	33
2.2.4 Tematika: Algjebra dhe funksioni	35
2.2.5 Tematika: Statistika dhe probabiliteti	37
2.3 Materiale dhe burime mësimore.....	38



FUSHA: SHKENCA NATYRORE.....	39
PROGRAMI I DITURISË SË NATYRËS.....	39
3.1 Hytje.....	39
3.2 Përmbajtja lëndore.....	40
3.2.1 Tematika: Diversiteti	40
3.2.2 Tematika: Ciklet.....	45
3.2.3 Tematika: Ndërveprimet	48
3.2.4 Tematika: Sistemet.....	51
3.3 Materiale dhe burime mësimore.....	54
FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”	55
PROGRAMI I LËNDËS EDUKIM PËR SHOQËRINË.....	55
4.1 Hytje.....	55
4.2 Përmbajtja lëndore.....	56
4.2.1 Tematika: Individët, grupet, shoqëria	56
4.2.2 Tematika: Kultura	58
4.2.3 Tematika: Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia	61
4.2.4 Tematika: Njerëz, vende dhe mjedise	63
4.2.5 Tematika: Pushteti, autoriteti, qeverisja.....	65
4.2.6 Tematika: Proceset shoqërore	67
4.2.7 Tematika: Prodhimi, konsumi, shpërndarja	69
4.3 Materialet dhe mjetet mësimore.....	71
FUSHA “EDUKIMIT FIZIK, SPORTE DHE SHËNDET”.....	72



PROGRAMI I EDUKIMIT FIZIK, SPORTE DHE SHËNDET.....	72
5.1 Hyrje.....	72
5.2 Përmbajtja lëndore.....	73
5.2.1 Tematika: Edukim nëpërmjet aktiviteteve fizike.....	73
5.2.2 Tematika: Aktivitete parasportive.....	76
5.2.3 Tematika: Edukim në shërbim të shëndetit, mirëqenies dhe komunitetit.....	77
5.3 Materialet dhe burimet mësimore	79
FUSHA ARTET.....	80
PROGRAMI I MUZIKËS	80
6.1 Hyrje.....	80
6.2 Përmbajtja lëndore.....	81
6.2.1 Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor.....	81
6.2.2 Tematika: Teknika dhe procese muzikore	83
6.2.3 Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria	85
6.3 Materiale dhe mjete mësimore	86
PROGRAMI I ARTIT PAMOR	87
7.1 Hyrje.....	87
7.2 Përmbajtja lëndore.....	88
7.2.1 Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik	88
7.2.2 Tematika: Teknika dhe procese artistike	90
7.2.3 Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.....	92
7.3 Materiale dhe mjete mësimore	93



PROGRAMI I TEATRIT	95
8.1 Hyrje.....	95
8.2 Përmbajtja lëndore.....	96
8.2.1 Tematika : Gjuha dhe komunikimi teatror.....	96
8.2.2 Tematika: Teknika dhe procese teatrorë	98
8.2.3 Tematika: Historia, teatri dhe shoqëria.....	100
8.3 Materiale dhe burime mësimore.....	103
PROGRAMI I KËRCIMIT	104
9.1 Hyrje.....	104
9.2 Përmbajtja e lëndës	105
9.2.1 Tematika : Gjuha dhe komunikimi i kërcimit.....	106
9.2.2 Tematika: Teknika dhe procese të kërcimit.....	109
9.2.3 Tematika: Historia, kërcimi dhe shoqëria.....	111
KOHA MËSIMORE SIPAS PROGRAMEVE LËNDORE.....	114



HYRJE

Programet e reja të arsimit parashkollor janë hartuar në kuadër të reformës kurrikulare të ndërmarrë në gjithë sistemin arsimor parauniversitar. Ky dokument derivon nga dy dokumente të rëndësishme të miratuara nga MASR-ja: “Korniza Kurrikulare e arsimit parashkollor” dhe “Standardet e zhvillimit dhe të nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç”.

Për hartimin e programeve të arsimit parashkollor ka punuar një grup i madh specialistësh të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), specialistë pranë zyrave të arsimit, pedagogë dhe njohës të mirë të fushës së fëmijërisë së hershme etj. Gjithashtu programet janë konsultuar dhe diskutuar me një grup të gjerë mësuesish të kopshteve dhe klasave pilot, kontributi i të cilëve është pasqyruar në këtë dokument.

Programet janë ndërtuar mbi qasjen me kompetenca dhe janë në koherencë me ciklet dhe shkallët e tjera të kurrikulës. Për çdo fushë të nxënimit janë ndërtuar programe, nëpërmjet të cilave përmbushen si rezultatet e kompetencave kyçe, ashtu edhe kompetencat lëndore. Programet përmbajnë njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime të diktuar nga treguesit e standardeve të zhvillimit dhe të nxënimit për secilën grupmoshë. Për secilën kompetencë/tematikë lëndore jepen njohuritë sipas grupmoshës së fëmijës 3-4, 4-5 dhe 5-6 vjeç (*grupi i parë, grupi i dytë dhe viti përgatitor*). Shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë fëmija lidhur me kompetencat/tematikat përkatëse paraqiten për të tria grupet.

Duke u mbështetur në përvojat më të mira bashkëkohore dhe në vlerat e traditës së institucioneve shqiptare parashkollore, mësuesit do të përzgjedhin veprimtari, strategji, lojëra, materiale dhe mjete të duhura që do të lehtësojnë kuptimin dhe zbatimin e tyre nga ana e fëmijëve. Gjithashtu, përmbajtja e programeve u krijon mundësi mësuesve që sipas metodologjisë që zbatojnë institucionet e tyre, të përshtasin fitimin e shkathtësive nga ana e fëmijëve.

Ky program do të zbatohet me fëmijët e moshës 5-6-vjeçare që janë të regjistruar në klasat përgatitore dhe në grupet e treta në kopshte.



Një falënderim i veçantë shkon për UNICEF-in dhe për Znj. Mirlinda Bushati, të cilët kanë ofruar ekspertizën më të mirë ndërkombëtare dhe kanë siguruar mbështetje teknike për hartimin dhe pilotimin e programeve të reja të arsimit parashkollor.



FUSHA “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”

PROGRAMI I LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE

1.1 Hyrje

Gjuha është një pasuri e çmuar njerëzore. Ajo u krijon mundësi njerëzve të zbulojnë veten, të njohin botën rreth tyre, të ndërtojnë marrëdhënie me të tjerët, të shprehin ndjenjat, t’u japin jetë ëndrrave dhe prirjeve të tyre, të pasurojnë botën e tyre emocionale, të zhvillojnë ndjenjën e të bukurës, të zgjidhin probleme, si dhe të prezantojnë njohuritë dhe idetë që kanë për çështje të ndryshme. Duke qenë kaq e rëndësishme në jetën njerëzore, gjuha shqipe është trajtuar si e tillë edhe në kurrikulën e arsimit parashkollor.

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën gjuhët dhe komunikimi. Kjo fushë u mundëson fëmijëve që të zhvillojnë dhe të përdorin gjuhët si mjete komunikimi në jetën e përditshme, si dhe të zhvillojnë kompetencat gjuhësore.

Kompetencat gjuhësore ndërtohen dhe zhvillohen gjatë gjithë jetës, por mosha parashkollore është vendimtare për arritjet e fëmijëve. Shpejtësia dhe lehtësia me të cilën fëmijët e vegjël mësojnë të flasin gjuhën, pa qenë të mësuar nga dikush tjetër, është një nga mrekullitë e natyrës. P.sh., nga mosha 3 deri në 5 vjeç fëmijët mësojnë afërsisht 50 fjalë të reja në muaj dhe gjatësia e fjalisë rritet çdo vit. Është detyrë e institucioneve arsimore që të pasurojnë dhe të zhvillojnë te fëmijët njohuritë dhe shkathhtësitë gjuhësore, sidomos gjatë viteve të para të jetës. Fëmijëve të vegjël u pëlqen të flasin. Ata i tërheq dhe u pëlqen të dëgjojnë histori të lexuara me zë të lartë në grupe të vogla apo në praninë e të rriturve. Atyre u pëlqen të shkëmbejnë librat e preferuar, “të lexojnë” libra dhe të ritregojnë histori. Në këtë mënyrë, mësimi i gjuhës ndodh brenda një konteksti social dhe kulturor. Mjedisi shoqëror u ofron fëmijëve më shumë sesa vetëm fjalë dhe kuptime. Fëmijët mendojnë dhe veprojnë në mënyra shoqërisht të pranueshme. Fëmijët mësojnë edhe rreth shoqërisë, ndërsa janë duke mësuar gjuhën.



Njohuritë dhe shkathtësitë e gjuhës së folur përbëjnë themelet për zhvillimin e mëtejshëm të shkathtësive të leximit dhe të shkrimit. Një hap i madh e i rëndësishëm në jetën e fëmijës është fillimi i mësimit të shkrimit. Në vitet e para, fëmija ka një shkrim që ngjason me shkarravina në formë rrethore. Më pas, fëmija përpiqet t'i kthejë këto shkarravina në forma më të rregullta dhe të njohë shkronjat. Aktivitetet, në të cilat fëmija ka mundësi të shkruajë në sipërfaqe vertikalisht, i japin mundësi të pozicionojë mirë kyçin e dorës dhe të përdorë mirë muskujt e gishtave në vend të muskujve të krahut. Fëmija duhet të ketë mundësinë të shkruajë në sipërfaqe të ndryshme e me materiale të ndryshme. Fillimisht ata i bëjnë shkronjat shumë të mëdha, por, më pas, ato do të zvogëlohen gradualisht. Shkronjat e para mund të kërkojnë që çdo shkronjë të harxhojë një fletë më vete. Megjithatë, aktivitetet e shkrimit nuk duhet të jenë të gjata dhe duhet të jenë të mbushura me mundësi që fëmija të vetëqetësohet. Shkrimi mund t'u duket i frikshëm fëmijëve të kësaj moshe, ndaj dhe aktivitetet duhet të planifikohen me kujdes, në mënyrë që t'i ndihmojnë fëmijët të kenë një qëndrim pozitiv ndaj shkrimit që në hapat e para.

Siç shihet, një arsim parashkollor cilësor është një parakusht i rëndësishëm jo vetëm për suksesin e fëmijëve në shkollë, por edhe në jetë, ndaj është detyrë e mësuesve të këtij cikli të mundësojnë ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Kompetencat e fushës gjuhët dhe komunikimi janë:

- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme;
- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar;
- Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare;
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.



1.2 Përmbajtja lëndore

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të fushës. Njohuritë përcaktohen për çdo grup, ndërsa shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet janë përcaktuar për të tria grupet së bashku. Shkathtësitë janë klasifikuar sipas disa tematikave.

1.2.1 Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Përshkrimi i kompetencës dhe rezultatet e të nxënit

Fëmija demonstroi sjellje dhe qëndrime të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si: vëmendje, pëlqim dhe interes. Ai dëgjon dhe kupton një larmi tekstesh të folura, demonstroi se i ka kuptuar këto tekste, si dhe shpreh opinionet vetjake rreth teksteve që dëgjon.

Fëmija demonstroi të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme; ritregon me fjalët e veta përmbajtjen ose informacionin kryesor të një bisede, poezie, përralle, tregimi, rregulle praktike ose udhëzimi.

Njohuritë

Fëmija dëgjon dhe reagon ndaj teksteve që janë të përshtatshme për moshën e tij/saj, si: përralla, tregime, ndodhi personale, shfaqje për fëmijë, teatër me kukulla etj. Ai/ajo, gjithashtu, merr njohuritë e mëposhtme për rregullat e thjeshta gjatë të dëgjuarit si: vëmendje, kontakt me sy.

Shkathtësitë

- **Rregullat e të dëgjuarit**

Fëmija:



- dëgjon më vëmendje bashkëmoshatarët dhe të rriturit;
- shfaq interes për informacione të ndryshme nga bashkëmoshatarët dhe të rriturit;
- zbaton udhëzimet ose porositë që kërkojnë realizimin e veprimeve me dy deri në tri komanda;
- zbaton rregullat e të dëgjuarit në grup.

- **Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të vlerësuar tekstin**

Fëmija:

- kupton udhëzime të thjeshta;
- kupton prezantime gojore të moshatarëve dhe të të rriturve rreth temave të përshtatshme për moshën e tij;
- u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;
- tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit;
- shpreh me gjuhë të thjeshtë përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një teksti (përrallë, tregim, histori, poezi etj.);
- shpreh me fjali të thjeshta pëlqimet e tij rreth ngjarjeve dhe personazheve të tekstit;
- kupton tekste të thjeshta joletrare e letrare;
- identifikon format e thjeshta letrare: përrallëza, përralla, tregime të shkurtra, vjersha, poezi etj.;
- kupton se gjuha e folur është e organizuar në tinguj, fjalë e fjali;
- dallon tinguj të ndryshëm në fjalë dhe fjalët në një fjali;
- pasuron fjalorin me fjalë të reja, me shprehje të veçanta gjuhësore dhe me fjali nga fusha të ndryshme të jetës.



Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- shfaq interes ndaj të tjerëve gjatë bashkëbisedimeve;
- merr pjesë në bashkëbisedime;
- respekton mendimin e të tjerëve;
- dëshmon vullnet dhe gatishmëri në detyra individuale dhe në grupe;
- përdor imagjinatën dhe shpirtin krijues në zgjidhjen e problemeve të ndryshme;
- tregon kureshtje dhe vetëbesim gjatë realizimit të detyrave të ndryshme.

1.2.2 Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Përshkrimi i kompetencës dhe rezultatet e të nxënit

Fëmija shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. Ai/ajo shpreh saktë dhe kuptueshëm mendimet vetjake për një temë ose tekst të përshtatshëm për moshën, shoqëron të folurin edhe me elemente joverbale, bashkëpunon në grup, si dhe merr pjesë në lojë me role.

Fëmija flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të vetën ose kur përshkruan diçka etj.; diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta; përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve dhe ekspozitave në klasë; merr pjesë në lojë me role.



Njohuritë

Nëpërmjet bisedave të përditshme tematike, të përshtatshme për moshën 5-6 vjeç, fëmija fiton njohuri për rregullat e thjeshta të të folurit.

Shkathtësitë

▪ Rregullat dhe organizimi i të folurit

Fëmija:

- flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka etj.;
- bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta;
- përdor fjali gjithnjë e më të plota dhe më komplekse;
- ndan me të tjerët përvojat, mbresat dhe emocionet e tij;
- njeh fjalët e shumë poezive ose këngëve;
- reciton përmendësh poezi të ndryshme;
- tregon brendinë e teksteve të tilla, si: përrallëza, përralla, tregime të shkurtra, gjëgjëza, poezi, fabula etj.;
- zhvillon më tej apo zgjeron idenë/mendimin e shprehur nga një person tjetër kur dëgjon me kujdes;
- përcjell një mesazh të thjeshtë me fjalët e veta;
- flet dhe diskuton për tema të ndryshme;
- merr pjesë në lojë me role;
- kujton dhe përsërit fjali dhe shprehje të plota nga të tjerët, duke përfshirë këtu edhe ato që dëgjon në televizion dhe reklama;
- përdor gjeste jo verbale, të tilla si shprehje a gjeste të fytyrës gjatë të folurit;



- tregon e ritregon ngjarjet duke i shoqëruar me gjeste;
- kënaqet duke përsëritur ngjarjet, poezitë dhe këngët.

- **Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup**

Fëmija:

- prezanton veten para të tjerëve;
- mban radhën në biseda dhe respekton të tjerët;
- diskuton në mënyrë aktive për atë që kanë dëgjuar;
- diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë dhe respekton rregullat e komunikimit në grup;
- pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë;
- merr pjesë në lojë me role.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- shfaq vëmendje ndaj të tjerëve gjatë bashkëbisedimeve;
- merr pjesë në bashkëbisedime;
- respekton mendimin e të tjerëve;
- dëshmon vullnet dhe gatishmëri në detyra individuale dhe në grupe;



- përdor imagjinatën dhe shpirtin krijues në zgjidhjen e problemeve të ndryshme;
- bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;
- kritikon duke u mbështetur mbi argumente;
- tregon kureshtje dhe vetëbesim gjatë realizimit të detyrave të ndryshme.

1.2.3 Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Përshkrimi i kompetencës dhe rezultatet e të nxënit

Fëmija lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekste të thjeshta letrare dhe joletrare. Ai përdor strategji të thjeshta për të kuptuar tekstin si: lidh tekstin me njohuritë e mëparshme, rilexon, pyet rreth paqartësive, mban shënime, bën nënvizime etj. Fëmija demonstroi kuptimin e tekstit duke treguar brendinë dhe ngjarjet kryesore. Fëmija, gjithashtu, nxjerr konkluzione të thjeshta dhe jep mendimet e tij rreth tekstit që lexon.

Njohuritë

Nëpërmjet përrallave, tregimeve, kartelave me fjalë dhe figurave që emërtojnë objekte të ndryshme, fëmija fiton njohuritë në lidhje me:

- shkronjat e shtypit dhe tingujt e gjuhës shqipe;
- fjalët më të përdorura në klasë, në kopsht/shkollë, në familje dhe në mjedisin që e rrethon;
- **Përdorim tekstesh letrare:** përralla të shkurtra, tregime me figura, poezi të thjeshta.
- **Përdorim tekstesh joletrare:** kartolina, revista për fëmijë.



Shkathësitë

▪ Të lexuarit fillestar

Fëmija:

- mban trupin në një qëndrim të përshtatshëm dhe librin në pozicionin e duhur gjatë kohës që lexon;
- bën sikur lexon duke lëvizur buzët;
- njeh dhe dallon pjesën me foto ose ilustrime dhe pjesën e shkruar në një tekst;
- jep përgjigje të thjeshta rreth tekstit;
- dallon shkronjat e shtypit dhe tingujt e gjuhës shqipe;
- lexon fjalët më të përdorura në klasë, në familje dhe në mjedisin që e rrethon;
- kupton tekstet që janë të shoqëruara me shumë ilustrime dhe me pak fjalë;
- njeh dhe kërkon rregullisht librat e preferuar;
- kupton se njerëzit lexojnë për një qëllim;
- dallon në një libër titullin, autorin, tekstin dhe ilustrimet;
- flet rreth pikturave dhe ilustrimeve në tekst;
- fillon të vëzhgojë faqet nga lart-poshtë dhe nga e majta në të djathtë;
- kupton kur një tekst është për t'u "lexuar";
- përdor figurat për të shprehur kuptimet e tyre dhe shfaq emocionet e tij;



- "lexon" me ndihmën e mësuesit hyrjen e tekstit, fjalët e pakta nga teksti;
- njeh shenjat ose simbolet në një mjedis (p.sh., STOP, shenjat e qarkullimit rrugor etj.);
- dallon shkronjat e shtypit;
- identifikon shkronjat fillestare dhe ato përfundimtare të fjalëve;
- bën dallimin mes fjalëve që tingëllojnë ngjashëm;
- identifikon shkronjat e emrit të tij;
- identifikon shkronja edhe në fjalë të tjera të rëndësishme për të;
- dallon shkronjat nga fjalët dhe nga fjalia;
- krijon fjalë që rimojnë me një fjalë të dhënë.
 - **Të lexuarit për të kuptuar**

Fëmija:

- tregon një histori me piktura, sipas rendit logjik: fillim, mes dhe fund;
- flet dhe shfaq emocione në varësi të tekstit;
- parashikon fundin e historive, duke u orientuar nga ilustrimet;
- imiton zërin e një personazhi;
- tregon pse i pëlqen një personazh në një tekst;



- tregon histori bazuar në eksperiencën e tij personale, imagjinatën, ëndrrat, librat etj.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- tregon interes dhe dëshirë për të lexuar dhe për të dëgjuar atë që i lexojnë të tjerët;
- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexohen.

1.2.4 Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Përshkrimi i kompetencës dhe rezultatet e të nxënit

Fëmija shkruan saktë dhe pa gabime drejtshkrimore tekste të thjeshta. Ai/ajo mbledh informacion nga burime të ndryshme para se të shkruajë kartolina, letra, plane të thjeshta, përshkrime etj. Me ndihmën e mësuesit fëmija rishikon tekstin e shkruar për të shmangur gabimet drejtshkrimore.

Fëmija shkruan për të komunikuar idetë e veta te të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive etj.; shkruan tekste të thjeshta (urim, letër, kartolinë) sipas modeleve të dhëna.

Njohuritë

- Kopjimi/ shkrimi i shkronjave të shtypit të gjuhës shqipe
- Kopjimi/ shkrimi i fjalëve 2-3 rrokëshe



- Shkrimi i një kartoline ose urimi të thjeshtë me ndihmën e të rriturit

Shkathtësitë

- **Rreth të shkruarit**

Fëmija:

- eksperimenton me mjetet dhe materialet e të shkruarit (laps, letër, ngjyra, shkumës etj.);
- përdor shkarravina, vizatime dhe letra për të shkruar;
- u tregon të tjerëve kuptimet e synuara në vizatimet dhe shkrimet e tij;
- kopjon ose shkruan shkronjat e shtypit të gjuhës shqipe;
- kopjon ose shkruan fjalë të thjeshta, si dhe shkruan një urim ose kartolinë me ndihmën e një të rrituri;
- bashkon pikat për të formuar shkronjat kapitale;
- përdor simbole ose vizatime për të përfaqësuar gjuhën e folur;
- kupton se një fjalë e thënë përfaqësohet nga diçka e shtypur;
- kopjon emrin e vet dhe më pas e shkruan vetë atë;
- kopjon disa prej shenjave të mjedisit ose simbole;
- dallon se disa shkronja janë të mëdha e disa të vogla (shkronjat e shtypit);
- njeh dhe shkruan shkronjat e shtypit;
- shkruan emrin e dikujt ose fjalë që lidhen me tematika të caktuara;



- lexon, shkruan ose kopjon fjalë të përdorura shpesh në jetën e përditshme;
- dallon shkronjat nga numrat;
- radhit fjalët e një fjalisë me 2-3 fjalë duke parë modelin.

- **Të shkruarit për qëllime të ndryshme**

Fëmija:

- përdor shkarravina për të shkruar lista, shkronja dhe histori;
- njeh disa prej shenjave mjedisore (p.sh. shenja “Stop”, “Hyrje”, “Dalje” etj.);
- kupton që fjalët e shkruara kanë një kuptim/qëllim;
- kërkon nga të rriturit që të përshkruajnë me shkrim vizatimin e tij;
- bën sikur shkruan shënime, duke përdorur shkronja të sajuara;
- kopjon dy-tre shenja ose simbole të mjedisit (p.sh.: një reklamë, një shenjë qarkullimi);
- kopjon fjalë të shkurtra 2-3 rrokëshe;
- njeh shenjat e ndryshme të printuara, p.sh.: shenjën për qëndrimin e një autobusi, taksie etj.;
- identifikon forma të ndryshme të shkrimit (me shkronja të mëdha, të vogla, me numra);
- shkruan urime, falenderime të shkurtra me ndihmën e të rriturve;
- shkruan fjali të thjeshta që shprehin një mendim personal;
- shpreh me vizatim dhe me fjali të shkurtra një ngjarje/histori.

Vlerat dhe qëndrimet



Fëmija:

- mban gjatë të shkruarit në pozicionin e duhur trupin, dorën, fletoren ose fletën ku shkruan;
- shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit;
- kënaqet me komentet e të rriturve për punimet e veta artistike dhe shkronjat;
- vlerëson punët e të tjerëve;
- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.

1.3 Materialet dhe burimet mësimore

Një nga çelësat për ndërtimin e një mjedisi të pasur për zhvillimin e kompetencave gjuhësore është sigurimi i pajisjeve të duhura, i librave dhe i materialeve për të shkruar. Një fillim i mbarë është sigurimi i shumë librave për fëmijë. Biblioteka duhet të ketë shumëllojshmëri tekstesh, si histori, libra me piktura, libra shkencorë, libra pa fjalë, poezi etj., albume, si edhe libra me format të madh që janë të rëndësishëm gjithashtu. Në klasë duhet të ngrihen këndet (qendrat) e leximit, të shkrimit dhe të dëgjimit, me librat dhe materialet e duhura, në mënyrë që të nxiten fëmijët të marrin pjesë në veprimtari të cilat do t'i ndihmojnë të përvetësojnë leximin dhe shkrimin gjatë aktivitetit të tyre ditor. Librat dhe materialet e tjera duhet të jenë të arritshme nga fëmijët, të vendosura në shporta apo në raftet e ulëta. Një vend i qetë për të lexuar, shkruar, pikturuar dhe vizatuar do të kontribuojë për krijimin e një mjedisi ku fëmijët do të mësojnë ta duan shkrimin dhe leximin. Në klasë duhet të ketë një larmi mjedesh që bëjnë të mundur shkrimin (lapsa me ngjyra, shkumësa, fletë në formate të ndryshme, shkronja me magnet, kompjuter, projektor etj.)



FUSHA E MATEMATIKËS

PROGRAMI I MATEMATIKËS

2.1 Hyrje

Fëmijët e vegjël janë kuriozë në mënyrë të natyrshme dhe zhvillojnë idetë matematikore që në fëmijërinë e hershme. Ata duan të kuptojnë mjedisin që i rrethon nëpërmjet vëzhgimeve, ndërveprimeve në shtëpi dhe në komunitet. Të mësuarit e matematikës zhvillohet në aktivitetet e përditshme, duke luajtur, duke treguar, duke prekur apo duke ndihmuar të tjerët. Këto aktivitete i ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e numrit dhe kuptimin e hapësirës. Kuriozitetet në lidhje me matematikën nxiten kur fëmijët krahasojnë sasinë, kur kërkojnë modele, dallojnë objekte, duke ndërtuar blloqe etj.

Një komponent kyç në zhvillimin e matematikës praktike është lidhja me eksperiencat personale të fëmijës. Mjedisi mësimor i fëmijës duhet të vlerësojë dhe të respektojë diversitetin e përvojave të fëmijëve, në mënyrë që ata të ndihen sa më “rehat” me matematikën dhe të nxiten të bëjnë sa më shumë pyetje duke zhvilluar kërkueshmërinë e tyre.

Matematika është shkenca, gjuha universale e së cilës ndihmon fëmijën të kuptojë dhe të veprojë në realitetin që jeton. Kjo e bën atë të japë një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin intelektual të fëmijës dhe për formimin e identitetit të tij. Nëpërmjet matematikës fëmija zhvillon përvoja nga më të thjeshtat te më komplekset dhe nga më konkretet te më abstraktet. Nëpërmjet mësimin të matematikës, fëmija merr njohuri mbi numrat, figurat, hapësirën, masat etj.

Kompetencat e matematikës, përshkrimi i tyre dhe rezultatet e të nxënimit sipas tematikave



Bazuar në këtë kurrikul, lënda e matematikës për arsimin parashkollor synon të përmbushë 4 kompetenca të cilat arrihen nëpërmjet tematikave kryesore të matematikës. Këto kompetenca renditen si më poshtë:

1. Zgjidhja e situatave të thjeshta problemore
2. Arsyetimi dhe komunikimi matematik
3. Modelimi matematik dhe lidhja konceptuale
4. Përdorimi i teknologjisë në matematikë

Kompetencat matematike	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas tematikave				
		Numri	Matja	Gjeometria	Algjebra dhe funksioni	Statistika dhe propabiliteti
Zgjidhja e situatës problemore	Fëmija përshkruan dhe zgjidh situata problemore të nivelit praktik; kërkon zgjidhje për detyrat, punon në grup me të tjerët për të zgjidhur një situatë problemore dhe provon strategji të ndryshme.	Fëmija: <ul style="list-style-type: none"> • kryen llogaritje të thjeshta matematikore në jetën e përditshme; • identifikon dhe zgjidh situata 	rendit, grupon, klasifikon dhe organizon objektet duke u nisur nga madhësia, pesha, lartësia, gjatësia dhe vëllimi; përdor mjete gjatë matjeve të objekteve në mjedisin që e rrethon.	identifikon dhe emërton format; bën vrojtime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive matematike.	identifikon modele të thjeshta nga jeta reale; bën vrojtime që ndihmojnë në të kuptuarit e një rregulli të caktuar.	<i>Zgjidhja problemore:</i> bën vrojtime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive.



		të thjeshta problemore.				
Arsyetimi dhe komunikimi matematik	<p>Fëmija përdor arsyetimin dhe komunikimin, si aspekte themelore të matematikës, të cilat kanë të bëjnë me organizimin logjik të fakteve, ideve ose koncepteve në mënyrë që të arrijë në një rezultat më të besueshëm se intuita.</p> <p>Fëmija përdor simbole për të paraqitur objekte, përdor objekte fizike për të modeluar gjuhën (p.sh: kur dëshiron të përshkruajë diçka), bën vizatime dhe përdor simbole për të përshkruar një situatë, bën lidhjen midis objekteve dhe simboleve (p.sh: kupton</p>	<p>përdor numrat për të parashikuar dhe ngritur hipoteza (p.sh: unë mendoj se janë 5 kuba në shportë, ja t'i numëroj); demonstroi të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, objekteve; krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me numra.</p>	<p>dallon menjëherë objektin që nuk i përket një grupi sendesh të dhëna; arsyeton ndarjen e objekteve në kategori në bazë të kriterëve të kërkuara (madhësi, ngjyrë, formë, sasi etj.)</p>	<p>demonstroi të kuptuarit e konceptit të numërimit, figurave dhe objekteve, komunikoi të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.</p>	<p>dallon dhe klasifikon modele duke diskutuar me të tjerët; komunikoi të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.</p>	<p>zbaton shprehjet të arsyetimit për të plotësuar tabelat.</p>



	kush është tualeti për femra nga simboli i vendosur mbi derë).					
Modelimi matematik dhe lidhja konceptuale	Fëmija përshkruan dhe krijon modele në situata të jetës së përditshme. Ai vëzhgon, krahason dhe vlerëson ngjarje dhe veprime, identifikon cilësi të ndryshme mbi të cilat mund të bëhen krahasimet ndërmjet objekteve (p.sh: sipas madhësisë, ngjyrës, formës), krahason personazhe apo ngjarje të ndryshme të cilat janë pjesë e tregimeve/përrallave, përshkruan ngjarjet duke përdorur shprehjet krahasuese (p.sh: sot hëngra më pak se dje), shpjegon se <i>si</i> dhe <i>pse</i> ka marrë një vendim të thjeshtë,	krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga jeta e përditshme duke përdorur numrat; bën lidhje të thjeshta mes numërimit.	vazhdon dhe përshkruan modelimet e dhëna; përshkruan <i>si</i> janë të organizuara ose të renditura objektet dhe përpiqet të japë edhe arsyen <i>pse</i> .	krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga jeta e përditshme; klasifikon figurat dhe objektet sipas një cilësie.	paraqet modelet, grupon dhe klasifikon sipas një cilësie të përbashkët.	paraqet numrat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.



	merr parasysh vëzhgimet/ mendimet e shokëve/ shoqeve për objekte/ ngjarje të ndryshme para se të marrë një vendim.					
Përdorimi i teknologjisë në matematikë	Fëmija përdor teknologjinë (p.sh. lojrat) si mjet për të identifikuar koncepte matemitkore.		përdor lojrat për përbërësit e një recete (miell, ujë, sheqer), mat rërën, ujin, orizin ose fasulet duke përdorur kupa/ gota/ filxhanë të madhësive të ndryshme.			përdor mjete të thjeshta, lojra, për paraqitje të formave, për llogaritje.

2.2 Përmbajtja lëndore

2.2.1 Tematika: Numri

<p>Përshkrimi i tematikës</p> <p>Fëmija përdor kuptimin e numrave, marrëdhëniet ndërmjet tyre për të paraqitur sasi në botën reale. Fëmija numëron; lexon, shkruan e përdor numrat; krahason numrat natyrorë dhe vlerëson me sy numrin e një sasi sendesh, pa i numëruar.</p>
<p>Njohuritë</p>



- **Numri natyror**

- Leximi i numërorëve deri në 20.
- Shkrimi i numërorëve nga 1-10.
- Kuptimi sasior për numrat deri në 10.
- Vlerësimi sasior (me sy) i një grupi me 2-5 sende.
- Numërimi me nga 1 të paktën deri në 20 me anë të konkretizimeve.
- Numërimi në rendin zbritës, duke filluar nga 10.
- Numri rreshtor (jo më shumë se 10 numra).

- **Krahasimi i numrave natyrorë**

- Krahasimi i dy grupe sendesh me anë të korrespondencës një për një.
- Përdorimi i shprehjeve “më shumë”, “më pak”, “po aq”.
- Renditja e numrave deri në 10, nga më i madhi te më i vogli dhe anasjellas, bazuar te paraqitjet konkrete.
- Përdorimi i shprehjeve “është më i madh”; “është më i vogël”.
- Krahasimi i numrave deri në 10 bazuar në dy grupe sendesh.

- **Mbledhja dhe zbritja e numrave natyrorë**

- Mbledhja si shtim, si bashkim, me anë të mjeteve konkrete e ilustrimeve.
- Zbritja si pakësim, si plotësim më anë të mjeteve konkrete e ilustrimeve.
- Mbledhja dhe zbritja, me 1 dhe 2 njësi, e numrave deri në 10.



- Përdorimi i simboleve “+”, “-“ dhe “=” nëpërmjet figurave.
- Zgjidhja e situatave të thjeshta problemore me një veprim.

Shkathësitë

Numri natyror

Fëmija:

- lexon numërorët deri në 20;
- shkruan numërorët nga 1-10;
- jep kuptimin sasior për numrat deri në 10;
- vlerëson (me sy) sasinë e një grupi me 2-5 sende;
- numëron me nga 1 të paktën deri në 20 me anë të konkretizimeve;
- numëron në rendin zbritës, duke filluar nga 10;
- njeh numrin rreshtor (jo më shumë se 10 numra).

▪ Krahasimi i numrave natyrorë

Fëmija:

- krahason dy grupe sendesh me anë të korrespondencës një për një;
- përdor shprehjet “më shumë”, “ më pak”, “po aq”;



- rendit numrat deri në 10, nga më i madhi te më i vogli dhe anasjellas, bazuar te paraqitjet konkrete;
- përdor shprehjet “është më i madh”; “është më i vogël”;
- krahason numrat deri në 10 bazuar në dy grupe sendesh;

- **Mbledhja dhe zbritja e numrave natyrorë**

Fëmija:

- vlerëson mbledhjen si shtim, si bashkim, me anë të mjeteve konkrete e ilustrimeve;
- vlerëson zbritjen si pakësim, si plotësim më anë të mjeteve konkrete e ilustrimeve;
- kryen mbledhje dhe zbritje, me 1 dhe 2 njësi, të numrave deri në 10;
- përdor simbolet “+”, “-“ dhe “=” nëpërmjet figurave;
- zgjidh situata të thjeshta problemore me një veprim.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;
- shfaq interes për numrat dhe numërimin;
- përdor imagjinatën për zgjidhjen e problemeve të thjeshta me numra;
- demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;



- demonstroi besim në forcat vetjake;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

2.2.2 Tematika: Matja

Përshkrimi i tematikës

Fëmija zbaton proceset e matjes, orientohet në kohë, njeh disa njësi standarde: ora, dita, java, muaji, viti. Njehsimet kufizohen në matjen e gjatësisë, kohës, masës duke përdorur njësi jo standarde dhe shprehjet krahasuese.

Njohuritë

▪ Gjatësia

- Matja e gjatësive me njësi jostandarde (hapi, pëllëmba, shiriti i letrës etj.).
- Krahasimi i sendeve sipas gjatësisë me sy ose duke i vendosur njëri mbi tjetrin.
- Përdorimi i terminologjisë përkatëse (“më i gjatë”, “po aq i gjatë”, “më i shkurtër”).
- Renditja e të paktën 4 sendeve nga më i gjati te më i shkurtri ose anasjelltas.

▪ Koha

- Renditja gjatë një dite e ngjarjeve kryesore të jetës së përditshme të fëmijëve.
- Përdorimi i fjalëve që tregojnë kohën: mëngjes, drekë, darkë; paradite, pasdite; ditë, natë.
- Përdorimi i shprehjeve “dje”, “sot”, “nesër”.



- Renditja e ditëve të javës, e muajve dhe stinëve të vitit.

▪ **Pesha**

- Krahasimi i masave të sendeve duke përdorur njësi jo standarde rrethore (molla, libri, lodër etj.).

- Përdorimi i terminologjisë përkatëse (“më i rëndë”, “më i lehtë”, “po aq i rëndë”) gjatë matjeve me njësi jostandarde.

▪ **Monedhat**

- Njohja me monedhat nga 10-lekëshe deri në 100-lekëshe.

- Parashikimi i mundësisë për një blerje që lidhet me një sasi të caktuar lekësh.

Shkathtësitë

▪ **Gjatësia**

Fëmija:

- mat gjatësinë e sendeve duke përdorur gjatësi jo standarde matjeje;

- vlerëson me sy gjatësinë e sendeve dhe i krahasin ato duke i vendosur mbi njëra – tjetrën;

- përdor njësitet jo standarde të matjes (“më i gjatë”, “po aq i gjatë”, “më i shkurtër”).

- rendit nga më i gjati te më i shkurtri ose anasjelltas të paktën 4 sende;



▪ **Koha**

Fëmija:

- përdor njësinë e përshtatshme të kohës (1 ditë, 1 javë, 1 muaj, 1 vit) për përcaktimin kohor të një veprimtarie ose ngjarjeje;
- përdor shprehjet: mëngjes, drekë, darkë; paradite, pasdite; ditë, natë, “dje”, “sot”, “nesër”.
- parashikon, në njësinë e përshtatshme të kohës, kohëzgjatjen e ngjarjeve që kanë lidhje me situata nga jeta e përditshme (p.sh., kohëzgjatja e pushimeve verore matet me ditë ose muaj etj.).

▪ **Masa**

Fëmija:

- përdor (me anë të veprimtarive konkrete dhe ilustrimeve) njësitë jo standarde në peshimin e sendeve përkatëse (“më i rëndë”, “më i lehtë”, “po aq i rëndë”).

▪ **Monedhat**

Fëmija:

- përdor monedhat nga 10-lekëshe deri në 100-lekëshe;
- zgjidh problema nga situata me blerje të njohura për ta.



Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- demonstroi kuriozitet për matjet e gjatësive, masave, kohës, monedhat;
- përdori imagjinatën për zgjidhjen e problemeve;
- demonstroi besim në forcat vetjake;
- respektoi përpjekjet personale dhe ato në grup.

2.2.3 Tematika: Gjeometria

Përshkrimi i tematikës

Fëmija njeh format dy dimensionale (katror, rreth, drejtkëndësh) dhe i kombinon ato me njëra-tjetrën për të krijuar figura të reja, dallon formën e ngjashme me një figurë gjeometrike në objektet në natyrë, duke marrë udhëzime nga të rriturit, dallon me një të parë nëse një figurë apo objekt i ngjan me një formë apo me trup gjeometrik.

Njohuritë

▪ Gjeometria në plan

- Emërtimi i figurave gjeometrike dydimensionale: rrethi, katrori, trekëndëshi, drejtkëndëshi.
- Gjetja në mjedisin rrethues e figurave të ngjashme me rrethin, katrorin, trekëndëshin dhe drejtkëndëshin.



- Vizatimi me dorë të lirë i formave gjeometrike (rreth, katror, trekëndësh, drejtkëndësh).
 - **Gjeometria në hapësirë**
- Gjetja në mjedisin rrethues e objekteve të ngjashme me kubin, sferën.
 - **Shndërrimet gjeometrike**
- Përcaktimi i vendodhjes së një objekti duke përdorur termat para- mbrapa, lart-poshtë, mbi-në-nën, majtas-djathtas, ndërmjet, afër-larg, brenda-jashtë etj.

Shkathtësitë

- **Gjeometria në plan**

Fëmija:

- dallon dhe emërton format 2D (katror, trekëndësh, rreth, drejtkëndësh);
- vizaton me dorë të lirë katrorin, trekëndëshin, drejtkëndëshin.

- **Gjeometria në hapësirë**

Fëmija:



- dallon dhe emërton në mjedise objekte në formë kubi, sferë etj.

- **Shndërrime gjeometrike**

Fëmija:

- përshkruan vendndodhjen e një objekti duke përdorur fjalë të orientimit në hapësirë, si: para, pas, lart, poshtë, përballë, majtas etj.
- lëviz në drejtime të caktuara, duke u orientuar nga fjalët (para; drejt; prapa derës; afër karriges; nën tavolinë; etj).

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;
- demonstroi kuriozitet për figurat 2D;
- përdor imagjinatën për kombinimin e figurave;
- demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime.

2.2.4 Tematika: Algjebra dhe funksioni

Përshkrimi i tematikës

Fëmija përdor imagjinatën për të modeluar sipas një rregulli të dhënë. Ai dallon një model konkret, kryesisht me karakter zbavitës, duke formuar edhe varg.



Njohuritë

▪ Funkzioni

- Dallimi i rregullit të përdorur në një varg objektsh duke mbajtur parasysh ngjyrën, formën, madhësinë, gjatësinë.
- Vazhdimi i një modeli duke ndjekur rregullin e dhënë.
- Gjetja e numërorit që mungon në vargun numerik, rritës ose zbritës, deri në 10.
- Veçimi, grupimi dhe klasifikimi i një grupi sendesh, sipas një cilësie të përbashkët.

Shkathësitë

Fëmija:

- dallon dhe vazhdon një varg sipas një rregulli me një ose dy kritere;
- gjen numërorin që mungon në një varg numerik me disa numra njëshifrorë.
- klasifikon grupe sendesh sipas një cilësie të përbashkët.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- përdor imagjinatën për krijimin e modeleve;
- demonstroi pavarësi në veprime;
- demonstroi besim në forcat vetjake;



- demonstroi vullnet në përfundimin e një modeli të kërkuar.

2.2.5 Tematika: Statistika dhe probabiliteti

Përshkrimi i tematikës

Fëmija lexon dhe kupton të dhëna të thjeshta tabelore. Ai lexon dhe plotëson një tabelë me të dhëna të thjeshta nga mjedisi i tyre.

Njohuritë

- Leximi i tabelave me të dhëna të thjeshta që kanë lidhje me jetën e përditshme të fëmijëve (p.sh., ditët me shi ose me diell brenda një jave).
- Vendosja e të dhënave të grumbulluara në tabela të dhëna (p.sh., frutat e ngrëna gjatë një dite).

Shkathtësitë

Fëmija:

- grumbullon, zbulon ose klasifikon grup sendesh apo figurash në bazë të një cilësie ose dy cilësive të përbashkëta (ngjyra, forma, trashësia etj.);
- lexon dhe plotëson tabela të thjeshta të gatshme me të dhëna të jetës së përditshme.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:



- është inovativ dhe paraqet informacionin në mënyra të ndryshme;
- përdor imagjinatën për klasifikimin e objekteve;
- përdor teknologjinë (lojrat) për paraqitjen e informacioneve të ndryshme.

2.3 Materiale dhe burime mësimore

Gjatë mësimit të matematikës mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat fëmija i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai përdor mjete pamore, teknologji të nevojshme, bën vizatime, modelime, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedise për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në matematikë duke e ndihmuar fëmijën të eksplorojë në situata të ndryshme. Materiale të imëta që mund të përdoren janë: materiale të riciklueshme; petëza; tabela manjetike; grafikë të numrave; kuti me forma të ndryshme; birila; numëratore me gogla; vargje me gogla; fletëpalosje për të lidhur numrin me sasinë; lodra të ndryshme; kuba; lapsa; fleta me dhe pa ngjyra; kavaleta pikturë; figura gjeometrike me forma dhe ngjyra të ndryshme; fije shkrepe; shkopinj didaktikë; grupe sendesh, objektsh; letra formati; lapsa, lapustila, lapsa me ngjyra etj.

Mësuesi përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta dhe me një fjalor të pasur. Mësuesi u krijon mundësi fëmijëve të demonstrojnë apo të prezantojnë në mënyra të ndryshme.



FUSHA: SHKENCA NATYRORE

PROGRAMI I DITURISË SË NATYRËS

3.1 Hyrje

Qëllimi i programit të shkencave të natyrës në arsimin parashkollor është nxitja e të mësuarit të shkencës nëpërmjet lojës, në një mjedis të sigurt dhe të dashur për fëmijët.

Programi i diturisë së natyrës, në arsimin parashkollor ndërthur tematikat: diversiteti, ciklet, ndërveprimet dhe sistemet. Sipas tyre strukturohet përmbajtja e mësimit të shkencave dhe integrimi konceptual brenda fushës. Ato reflektojnë një qasje integruese ku të nxënit e fëmijës zhvillohet nëpërmjet lojës dhe kërkimit.

Kompetencat e fushës

Kompetencat shkencore zhvillohen përmes tematikave dhe në program zërthehen në njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime. Ato janë:

- identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre;
- përdorimi i mjeteve, i objekteve dhe i procedurave shkencore;
- komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës.

Këto kompetenca janë komponentë të kompetencës së kërkimit shkencor. Kompetenca e kërkimit duhet të zhvillohet përmes përvojave që u lejojnë fëmijëve parashkollorë gjetjen dhe të nxënit e koncepteve themelore nëpërmjet hetimit, kërkimit, zbulimit, vëzhgimit dhe eksperimentimit,



si dhe vendosjen e këtyre koncepteve në kontekste reale. Lidhja e të nxënit me përvojat reale të fëmijëve dhe jetën e përditshme, i motivojnë ata për një të nxënë të kuptimshëm dhe të dobishëm për jetën.

3.2 Përmbajtja lëndore

3.2.1 Tematika: Diversiteti

Përshkrimi i tematikës

Kjo tematikë nënvizon rëndësinë e ruajtjes së shumëllojshmërisë në natyrë. Për të kuptuar më mirë botën në të cilën jetojmë, njeriu përpiqet të organizojë botën e gjallë dhe jo të gjallë. Ka disa tipare të përbashkëta që lidhin të gjitha qeniet e gjalla dhe faktorë unikë në botën jo të gjallë që e ndihmojnë njeriun t'i klasifikojë ato. Ruajtja e shumëllojshmërisë siguron mbijetesën dhe vazhdimësinë e jetës. Në fokus të kësaj tematike është diversiteti i kafshëve, i bimëve, i mjedisit natyror, i lëndëve, i vetive dhe i karakteristikave të tyre.

1. Diversiteti dhe klasifikimi i gjallesave

Njohuritë

- Karakteristikat e jashtme të kafshëve dhe bimëve.
- Ngjashmëritë dhe ndryshimet të kafshët dhe bimët e mjedisit përreth.

Shkathtësitë

Fëmija:



- vëzhgon dhe identifikon pjesët e jashtme të trupit të kafshëve, si: koka, këmbët, bishti, qimet, puplat etj.;
- bën pyetje të thjeshta që lidhen me pamjen e jashtme të kafshëve që vëzhgon ose shikon në fotografi;
- jep informacion/të dhëna që lidhen me karakteristika të veçanta të kafshëve që merren në analizë;
- dallon 2-3 cilësi të kafshëve brenda një grupi;
- tregon 2-3 karakteristika të veçanta të kafshëve të buta krahasuar me kafshët e egra, të shpendëve krahasuar me insektet;
- vëzhgon dhe identifikon pjesët kryesore të bimës: rrënja, kërcelli, gjethja, lulja, fruti, fara, trugu, dega;
- bën pyetje në lidhje me pjesë të caktuara të trupit të bimëve;
- tregon ndryshimet që vë re në një bimë gjatë ndërrimit të stinëve;
- krijon skeda të thjeshta për bimët dhe kafshët që vëzhgon;
- nxjerr përfundime të njohura duke u nisur nga të dhënat që ka mbledhur vetë ose i ndihmuar nga i rrituri.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- shfaq kuriozitet për botën e gjallesave;
- tregon interes për të mësuar më tepër në lidhje me kafshët e buta, kafshët e egra, shpendët dhe insektet;
- shprehet në rastet kur sheh se po dëmtohet një kafshë a një bimë;
- shfaq kënaqësi në lidhje me shumëllojshmërinë dhe bukurinë e botës së kafshëve dhe të bimëve.

Veprimtari të sugjeruara



- ➔ Shëtitje në mjedisin përreth për të vëzhguar bimët që gjenden aty
- ➔ Vizitë në një dyqan lulesh ose kafshësh shtëpiake
- ➔ Bisedë me një veteriner
- ➔ Krijimi i këndit të “qenieve të gjalla” në klasë, si p.sh.: një akvarium me peshq ose me breshka uji, një kafaz me kanarina ose papagaj, një kafaz me kavie, lepuj etj., në mënyrë që fëmijët të kujdesen për to, por edhe të shohin si rriten dhe zhvillohen.
- ➔ Krijimi i një sere ose parcele të vogël në oborr për kryerjen e mbjelljeve të farave të ndryshme.
- ➔ Vizitë në një kopsht zoologjik etj.
- ➔ Demonstrime me anë të fotografive, posterave, albumeve, CD didaktike etj.
- ➔ Eksperimente të ndryshme etj.

2. Diversiteti i mjedisit natyror

Njohuritë

- Diversiteti i mjedisit natyror të afërt.
- Peizazhi natyror
- Peizazhi i ndërtuar

Shkathësitë

Fëmija:



- vëzhgon dhe dallon diversitetin e peizazhit natyror në mjedisin e afërt;
- vëzhgon dhe identifikon mjediset e ndërtuara nga njeriu;
- bën pyetje rreth elementeve të mjedisit (tokës, ujit, ajrit, zjarrit);
- përshkruan me gojë itinerarin që ndjek nga shtëpia në kopsht (shkollë), nga shtëpia e vet te gjyshërit etj.;
- emërton mjediset që sheh në natyrë (malin, fushën, lumin etj.)
- kupton dhe tregon për rëndësinë e ujit dhe të ajrit për jetën si dhe zgjidhje të thjeshta për t'i mbrojtur ato;
- emërton dhe është në gjendje të dallojë midis burimeve të zjarrit dhe të ujit si dhe të shpjegojë përfitimet dhe rreziqet e tyre;
- përshkruan duke përmendur detaje të dallueshme për mjedisin që vëzhgon;
- bën pyetje ose komente në lidhje me peizazhin që vëzhgon.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- shfaq kuriozitet për të njohur mjedisin që e rrethon;
- vlerëson bukuritë natyrore dhe peizazhet e bukura të ndërtuara nga dora e njeriut;
- shfaq dëshira personale që lidhen me përmirësimin e mjedisit ku jeton.
- respekton të tjerët kur flasin.

Veprimtari të sugjeruara

- ➔ Shëtitje në mjedis për të vëzhguar peizazhin natyror dhe të ndërtuar nga njeriu.



- ➔ Vizita në vende me peizazhe të bukura natyrore ose të ndërtuara nga njeriu. Ekskursion mësimor pranë një pylli, lumi, deti, mali a liqeni më të afërt të zonës
- ➔ Vëzhgimi i rrugëve në të cilat lëvizin mjetet e transportit rrugor.
- ➔ Vëzhgimi i fotografive të bëra gjatë udhëtimeve që kanë bërë fëmijët me prindërit e tyre ose i kartolinave me peizazhe të bukura shqiptare.

3. Diversiteti i lëndëve

Njohuritë

- Vetitë dhe karakteristikat e lëndëve.
- Gjendjet dhe përzierjet e lëndëve.

Shkathësitë

Fëmija:

- tregon veti të lëndëve (ngjyra, cilësia, madhësia, forma);
- përdor vëzhgimet individuale kur pyetet për të përshkruar karakteristikat e lëndëve dhe të objekteve të vëzhguara;
- vendos materialet dhe objektet sipas një rendi ose në grupe sipas një ose më shumë cilësive që kanë;
- përshkruan disa veti të materialeve dhe të objekteve përreth;
- dallon se lëndët janë të përshtatshme për përdorime të caktuara bazuar në vetitë e tyre;
- përzgjedh dhe përdor materiale për të kryer vetë eksplorime;



- tregon se lëndët mund të ruhen, ripërdoren dhe riciklohen për të ruajtur një mjedis të shëndetshëm;
- merr pjesë së bashku me të rriturit, në eksperimente të thjeshta dhe është në gjendje të përshkruajë atë që vëzhgon;
- vëzhgon dhe dallon 2-3 lëndë që e thithin ose jo ujin;
- tregon 1-2 cilësi të ujit dhe të lëndëve me të cilat ndeshet/ punon çdo ditë;
- vëzhgon ekperimentet dhe përshkruan tri gjendjet e ujit;
- bën parashikime të përfundimeve të eksperimenteve të njohura;

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- shfaq kuriozitet në kryerjen e ekperimenteve;
- shfaq interes për të marrë pjesë në përgatitjen e gatimeve të thjeshta;
- tregon mënyra si mund ta kursejë ujin në familje.

Veprimtari të sugjeruara

- ➔ Ekperimente të ndryshme për të provuar tri gjendjet e ujit.
- ➔ Eksperimente me përzierje lëndësh të ndryshme.
- ➔ Eksperimente për të dalluar vetitë e lëndëve më të pranishme në jetën e përditshme.
- ➔ Vëzhgime në natyrë për të vënë re dukuritë e provuara në klasë.

3.2.2 Tematika: Ciklet



Përshkrimi i tematikës

Në natyrë ka ndryshime që përsëriten në mënyrë ciklike. Shembuj të tyre janë ciklet jetësore të qenieve të gjalla, cikli i ujit etj. Të kuptuarit e këtyre cikleve e ndihmon njeriun të parashikojë ngjarjet dhe proceset dhe të vlerësojë Tokën si një sistem të vetëqëndrueshëm.

Kjo tematikë përqëndrohet në ciklet e proceve jetësore të bimët, kafshët, njeriu, moti, atmosfera, sistemi diellor dhe Toka, përzierjet dhe ndryshimet e lëndëve, nxehtëja dhe ftohja.

Njohuritë

Rritja dhe ndryshimi të:

- a) kafshët;
- b) bimët;
- c) njeriu.

Shkathtësitë

Fëmija:

- zbulon vazhdimësi dhe ndryshime kur vëzhgon procese të rritjes dhe përdor komunikimin gjuhësor për t'i përshkruar këto ndryshime;
- vëren se bimët rriten, lulëzojnë dhe ndryshojnë pamjen e tyre;
- bën pyetje kur vëzhgon dhe përshkruan ciklin jetësor të një organizmi që pëson ndryshime shumë të mëdha;



- dallon disa tipare të njeriut që ndryshojnë me kalimin e kohës si: gjatësia, dhëmbët, rrudhat, flokët;
- bën pyetje dhe ofron shpjegime në lidhje me rritjen dhe zhvillimin e kafshëve dhe njeriut;
- nxjerr përfundime nga vëzhgimet dhe me ndihmën e të rriturit se qeniet e gjalla kanë një cikël jetësor;
- vëzhgon, emërton dhe përshkruan ndryshimet që pëson fara e mbjellë gjatë rritjes;
- vëzhgon, emërton dhe përshkruan ndryshimin e ngjyrës së gjetheve të pemës në stinën e vjeshtës;
- vëzhgon, emërton dhe përshkruan çeljen e zogut nga veza dhe fazat e rritjes së tij;
- vëzhgon si kujdesen prindërit për mirërritjen e të vegjëlve të tyre;
- përshkruan me detaje fazat e rritjes së vet duke i ilustruar me fotografi ose vizatime;
- tregon 2-3 ndryshime që ndodhin gjatë rritjes ndërmjet një vajze dhe një djali;
- tregon tipare të ngjashme që ka me prindërit e vet;
- bën pyetje që lidhen me fazat e rritjes së gjallesave;
- jep përgjigje duke u nisur nga vëzhgime të drejtpërdrejta të gjallesave ose nga informacionet e siguruar nga enciklopeditë për fëmijë, filmat vizatimorë, interneti etj.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- shfaq kuriozitet për ciklet jetësore të gjallesave;
- tregon dashuri dhe kujdes për të vegjël të kafshëve të buta/shtëpiake;
- tregon kujdes për bimët e sapombjella.



Veprimtari të sugjeruara:

- ➔ Eksperimente.
- ➔ Vëzhgimi i rritjes së bimëve në mjedise me ose pa dritë, ngrohtësi dhe ujitje.
- ➔ Vizitë në një pulari/spital kafshësh etj.
- ➔ Tregime e përralla të lidhura me këtë tematikë.
- ➔ Libra për fëmijë.
- ➔ Takim me një veteriner ose lulishtar.

3.2.3 Tematika: Ndërveprimet

Përshkrimi i tematikës

Studimi i ndërveprimit midis dhe brenda sistemeve zhvillon të kuptuarit e mjedisit dhe rolit të njeriut në të. Ndërveprimet ndodhin brenda një organizmi, ndërmjet organizmave, si dhe ndërmjet organizmave dhe mjedisit. Ndërveprimi i njeriut me mjedisin drejton zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë. Në të njëjtën kohë shkenca dhe teknologjia ndikojnë në mënyrën si njeriu ndërvepron me mjedisin. Të kuptuarit e këtij ndërveprimi e ndihmon fëmijën të kuptojë më mirë pasojat pozitive dhe negative të veprimeve të tij dhe të jetë përgjegjës për to.

Ndërveprimi njeri-mjedis

Njohuritë

- Notimi dhe zhytja e trupave.



- Roli i njeriut në mjedisin përreth.
- Ndërveprimi i trupave.

Shkathësitë

Fëmija:

- përshkruan karakteristikat e motit bazuar në vëzhgimet individuale;
- vëren vijueshmëri dhe modele në dukuritë e motit dhe përdor komunikimin gjuhësor për t'i përshkruar këto ngjarje duke përfshirë terma si: mot me erë / me mjegull/ me diell/ ngrohtë / nxehtë / ftohtë etj.;
- emërton dhe dallon stinët e vitit etj.;
- përshkruan disa veti të stinës lidhur me karakteristikat e motit dhe veshjet e tyre;
- dallon disa ndryshime që ndodhin në natyrë dhe fillon të kuptojë lidhjen shkak-pasojë (p.sh: dolën yjet se u bë natë, do filloj të shkoj në plazh se erdhi vera; gjethet po bien se erdhi vjeshta etj.);
- tregon se procesi i formimit të shiut është një cikël i cili është i ngjashëm me atë që ndodh në natyrë;
- dallon trupat që notojnë dhe ata që zhyten;
- gjen një mënyrë për ta bërë një trup që noton të zhytet;
- vëzhgon dhe përshkruan ndikimin pozitiv dhe negativ të njeriut në mjedisin rrethues;
- ripërdor aq herë sa është e mundur materialet që përdor në jetën e përditshme në shtëpi dhe klasë;
- përdor materiale të riciklueshme në punimet që kryen;
- nxjerr përfundime të njohura nga eksperimentet që kryen;
- vëzhgon dhe identifikon sendet dhe materialet që tërhiqen nga magneti;



- përshkruan me fjalët e duhura çfarë ndodh në rastet, kur luan me plastelinën, llastikun, një tel të përkulshëm, një sustë etj.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- shfaq interes në plotësimin e kalendarit të motit për çdo ditë;
- shfaq kuriozitet për të mësuar rreth karakteristikave të stinëve dhe motin në secilën prej tyre;
- ndërmer nisma për mbajtjen pastër të mjedisit rrethues;
- gjen të paktën një pasojë në raset e dëmtimit/prishjes së një mjedisi;
- ofron të paktën një zgjidhje për një situatë ose rast kur mjedisi është i dëmtuar/ i ndotur.

Veprimtari të sugjeruara

- ➔ Shëtitje në natyrë në të njëjtin mjedis, por në stinë të ndryshme
- ➔ Herbarium me gjethe
- ➔ Kalendar i motit
- ➔ Eksperimente për notimin e trupave
- ➔ Eksperimente me magnet
- ➔ Eksperimente me materiale të ndryshme
- ➔ Kolazhe
- ➔ Shëtitje në natyrë për të parë rastet e ndotjes ose të dëmtimit të një mjedisi natyror.



3.2.4 Tematika: Sistemet

Përshkrimi i tematikës

Një sistem përfaqëson një tërësi pjesësh të cilat punojnë së bashku për të kryer një funksion të caktuar. Ka sisteme në natyrë, si dhe sisteme të ndërtuara nga njeriu. Shembuj të sistemeve në natyrë janë sistemet e trupit të njeriut. Shembuj të sistemeve të ndërtuara nga njeriu janë sistemet elektrike. Njohja e sistemeve e lejon njeriun të kuptojë si funksionon secila pjesë e sistemit dhe si ndërveprojnë me njëra-tjetrën për të kryer një funksion të caktuar.

Kjo tematikë përqëndrohet te studimi i sistemit të bimëve dhe të kafshëve, sistemit elektrik, sistemit diellor dhe Tokës, sistemeve të orientimit dhe të lëvizjes (si harta dhe globi) dhe sistemeve të matjes.

Sistemet natyrore të tokës

Njohuritë

- Karakteristikat e motit në stinë të ndryshme.
- Ndikimi i kushteve të motit në jetën e përditshme.

Shkathtësitë

Fëmija:

- emërton dhe dallon pjesë të ndryshme të kohës (ditën, natën; ditët e javës, muajt;



- bën përshkrime të shkurtra për të treguar veprimtari që kanë ndodhur gjatë ditës ose natës;
- dallon disa ndryshime që ndodhin në natyrë dhe fillon të kuptojë lidhjen shkak-pasojë (p.sh: dolën yjet se u bë natë);
- lidh ditët e javës me veprimtari që kryen vetë ose me familjen gjatë tyre;
- lidh stinët dhe muajt e tyre me veprimtaritë që kryen vetë ose me familjen gjatë tyre;
- përdor fjalët e duhura në përshkrimin e motit dhe ndryshimet e tij në stinët e vitit;
- bën parashikime të afërta për motin për 1-2 ditët e ardhshme;
- tregon me 1-2 shembuj se si ndikojnë kushtet e motit në veshjen e njeriut, në përdorimin e pajisjeve të caktuara, në ngrohjen apo freskimin e mjedisit, në lojërat e ndryshme, në lëvizjen e mjeteve të transportit, në pushime etj.;
- bën lidhje të thjeshta ndërmjet shkaqeve të ndryshme dhe pasojave që sjellin.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- shfaq interes në plotësimin e kalendarit të motit për çdo ditë;
- shfaq kuriozitet për të mësuar rreth karakteristikave të stinëve dhe motin në secilën prej tyre.

Veprimtari të sugjeruara

- ➔ Fotografi të veprimtarive dhe aktiviteteve që bëhen nga fëmijët gjatë ditës dhe natës
- ➔ Regjimi ditor



Sistemi diellor dhe Toka

Njohuritë

- Dita dhe nata

Shkathësitë

Fëmija:

- vëzhgon dhe përshkruan karakteristikat e ditës dhe veprimet që kryen gjatë saj;
- vëzhgon dhe përshkruan karakteristikat e natës dhe veprimtaritë që kryen gjatë saj;
- përshkruan çfarë shikon në një natë me qiell të pastër;
- dallon lëvizjen e diellit gjatë ditës, të hënës dhe të yjeve gjatë natës.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- shfaq interes për të regjistruar çfarë bën gjatë ditës;
- shfaq kuriozitet për të vëzhguar qiellin natën;

Veprimtari të sugjeruara



- ➔ Fotografi të veprimtarive dhe aktiviteteve që bëhen nga fëmijët gjatë ditës dhe natës
- ➔ Regjimi ditor

3.3 Materiale dhe burime mësimore

Për realizimin e kompetencave në fushën e shkencave të natyrës është e domosdoshme të krijohet një mjedis mësimor i përshtatshëm. Më poshtë paraqitet një listë përmbledhëse e materialeve, burimeve dhe mjediseve të domosdoshme për realizimin e programit të kësaj lënde.

- Materiale didaktike, revista, enciklopedi, mjete për realizimin e eksperimenteve në klasë etj.
- Postera, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame të thjeshta, mjete grafike etj.
- Radio, magnetofon, telefon, kasetofon, televizor, video, video-projektor, videokasetë, kompjuter, CD.



FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

PROGRAMI I LËNDËS EDUKIM PËR SHOQËRINË

4.1 Hyrje

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i krijon fëmijës mundësi të zhvillojë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tij si anëtar i një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Nëpërmjet programit të kësaj lënde synohet që fëmija të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake, por jo vetëm dhe të përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Kompetencat e lëndës

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” ka në fokus kryesisht zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare. Kjo kompetencë përbëhet nga kompetencat personale, ndërpersonale dhe ndërkulturore që përfshijnë dhe lidhen me të gjitha qëndrimet që përgatisin individët për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme dhe konstruktive në jetën dhe punën shoqërore.

Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit, kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë fëmijëve, që nën udhëheqjen e mësuesit apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to.



4.2 Përmbajtja lëndore

4.2.1 Tematika: Individët, grupet, shoqëria

Përshkrimi i tematikës

Fëmijët kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë marrëdhëniet shoqërore. Ata dallojnë dhe shpjegojnë rolin dhe ndikimin e ndryshëm që kanë në shoqëri lloje dhe forma të caktura institucionesh sociale dhe shqyrtojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata studiojnë larminë e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve në shoqëri, eksplorojnë faktorët, që qëndrojnë në themel të tyre, mënyrën si funksionojnë dhe ndryshojnë.

Fëmijët marrin vendime për qëndrime e sjellje të ndryshme, që kanë lidhje me jetën dhe bashkëjetesën paqësore në shoqëri.

Njohuritë

Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi:

- i konceptit për veten;
- i konceptit për familjen;
- i konceptit për komunitetin;
- i konceptit për klasën dhe shkollën;
- i konceptit për shoqërinë dhe miqësinë;
- për bashkëveprimin me të tjerët;
- për marrëdhëniet brenda grupit;



- për të drejtat e fëmijëve.

Konceptet kryesore: *unë, ti, familja, klasa, lagjja, nevoja, dëshira, dallimi, e përbashkëta, unë dhe tjetri, përgjegjësi, respekt, nevoja të përbashkëta, dëshira të përbashkëta, punë e përbashkët, punë shtëpie, punë klase, punë në komunitet, respekt.*

Shkathtësitë

Fëmija:

- flet dhe përshkruan veten;
- identifikon dhe përshkruan emocionet që përjeton (p.sh., gëzim, frikë, mërzitje etj.);
- flet për të drejtat, gjërat që i pëlqejnë, nevojat dhe dëshirat;
- identifikon dhe përshkruan karakteristika të pjesëtarëve të familjes dhe të shokëve /shoqeve;
- diskuton (bashkëbisedon) mbi ngjashmëritë dhe dallimet (p.sh., sytë, flokët, lartësia, talentet, gjinia, interesat, preferencat për ushqimin etj.);
- sugjeron ide ose veprime për t'iu përshtatur ndryshimeve përgjatë lojës ose në aktivitetet në grup;
- identifikon dhe ndjek rregulla dhe rutina në klasë (p.sh., vendos sendet personale në vendin e përcaktuar, larja e duarve, pastrimi etj.);
- kujdeset për pajisjet në klasë/ kopsht/ shkollë dhe në mjedise të tjera publike (p.sh., pajisjet në klasë, bimët në park etj.);
- tregon ngjarje personale, familjare dhe shoqërore;
- tregon 2-3 tipare që e dallojnë nga të tjerët;
- dallon rolet e veçanta që individët kanë në familje, klasë, grup, lagje etj.;
- dallon lidhjet që ai ka me mjedisin që e rrethon dhe me njerëzit që e përbëjnë atë: - njerëzit e familjes, - shokët (në shkollë e jashtë saj),- mësuesen,- sendet me të cilat ka lidhje në jetën e përditshme, - mjedisin etj.;
- dallon nevojën që ka për njerëzit dhe mjedisin që e rrethon;



- dallon atë çfarë mund t'u japë të tjerëve dhe mjedisit që e rrethon;
- shpreh përgjegjësinë e tij ndaj të tjerëve dhe mjedisit etj.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- shpreh mendimet, ndjenjat, dëshirat e tij;
- beson te vetja dhe tek të tjerët;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup;
- respekton vetveten;
- tregon interes për nevojat e të tjerëve;
- ndan gjërat me shokët e klasës;
- respekton idetë dhe përvojat e të tjerëve;
- bashkëvepron me të tjerët me bindjen se kjo është e nevojshme;
- tregon gadishmëri për të ndihmuar shokët, të moshuarit etj.

4.2.2 Tematika: Kultura

Përshkrimi i tematikës



Fëmijët kuptojnë si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë së bashku dhe përshtaten ndaj kulturës. Ata vlerësojnë rolin e kulturës në formimin e jetës dhe të shoqërisë ku jetojnë, marrin vendime mbi bazën e njohurive të marra për kulturën, në emër të respektimit të diversitetit kulturor dhe të bashkëjetesës paqësore ndërmjet njerëzve dhe kulturave.

Njohuritë

Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi për:

- jetën në komunitet;
- ngjashmëritë dhe ndryshimet me të tjerët;
- sjelljen qytetare;
- etikën si e mirë e përbashkët;
- fqinjësinë e mirë;
- simbolet kombëtare;
- gjuhën, zakonet dhe traditat;
- gatimet dhe ceremonitë tradicionale/ festive;
- ditët dhe datat e shënuara;
- përkatësia dhe respekti për veten;
- vlerat njerëzore.

Shkathtësitë

Fëmija:



- dallon ngjashmëritë me të tjerët brenda grupit shoqëror në të cilin bën pjesë (familje, klasë, komunitet);
- dallon ndryshimet më të dukshme kulturore brenda grupit shoqëror në të cilin bën pjesë (familje, klasë, komunitet);
- përshkruan si familjet kanë tipare të përbashkëta dhe të veçanta;
- përshkruan detyra dhe përgjegjësi të anëtarëve të familjes;
- tregon për festat dhe traditat në familje (p.sh., ditëlindje, festa etj);
- identifikon simbole të vendit tonë (p.sh., flamuri);
- shpreh krenari për identitetin kombëtar;
- shpreh mendime pozitive për veten dhe për shokët e "ndryshëm";
- sillet në mënyrë qytetare;
- përdor fjalët "magjike";
- kërkon zbatimin e të drejtave që i takojnë.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- kupton se pavarësisht ndryshimeve, të gjithë janë të barabartë;
- vlerëson sjelljet qytetare në interes të së mirës së përbashkët;
- merr pjesë me dëshirë në ceremoni festive;
- shfaq respekt për veten dhe për të tjerët;
- gëzohet kur merr pjesë në festa, ditë e data të shënuara.



4.2.3 Tematika: Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia

Përshkrimi i tematikës

Duke studiuar të kaluarën dhe trashëgiminë e saj, fëmijët kuptojnë konceptet kyçe historike si; kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia, lidhjet shkak- pasojë, shumëllojshmëria kulturore etnike dhe fetare, rëndësia dhe perspektiva, fillimisht nëpërmjet njohjes dhe kuptimit të historisë personale dhe familjare, historisë së shkollës, historisë së zonës, rajonit për t'u zgjeruar e më pas në njohjen dhe kuptimin e historisë së vendit dhe atë të qytetërimeve botërore. Kuptimi i kronologjisë aftëson fëmijët të kuptojnë vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe marrëdhënien shkak-pasojë. Fëmijët kuptojnë rolin e kohës në ndryshueshmërinë e njerëzve, të shoqërisë dhe mjedisit, duke njohur disa nga ndryshimet më të rëndësishme që kanë ndodhur, duke filluar nga elementet e jetës së përditshme e deri në ndryshimet shoqërore, ekonomike, kulturore, që kanë formësuar botën.

Njohuritë

Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi për:

- rritjen dhe ndryshimet që ndodhin gjatë saj;
- përkatësinë, gjininë;
- brezat në familje;
- historikun e shkollës;
- ndryshimet në veshje, shije, ushqime, lodra etj., që ndodhin me rritjen e njeriut;
- ndryshimi i vendbanimit.



Shkathësitë

Fëmija:

- dallon ndryshimet që i kanë ndodhur gjatë rritjes;
- përshkruan pse njerëzit ndryshojnë me kalimin e kohës;
- përshkruan si ndryshon familja me kalimin e kohës;
- rendit ngjarjet sipas kohës kur kanë ndodhur;
- flet për momente të veçanta të jetuara në familje, kopsht, shkollë;
- lidh kohën me elemente, objekte, shenja apo gjëra të veçanta;
- ilustron me shembuj, vizatime, foto, regjistrime filmike, ngjarje të ndodhura në kohë të ndryshme;
- bën dallime ndërmjet mjediseve ku i është dashur të jetojë, mësojë, luajë.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- shpreh ndjenja dhe emocione pozitive për të kaluarën e vet;
- shpreh pëlqim ose mospëlqim sipas situatës apo kontekstit në/ për të cilin ndodhet/ flitet;
- mban qëndrimin e duhur në situata të vështira;
- vlerëson përparimin e teknologjisë, shkencës, shoqërisë duke u nisur nga jeta e përditshme;
- justifikon veprime/gabime që ka bërë kur ka qenë më i vogël.



4.2.4 Tematika: Njerëz, vende dhe mjedise

Përshkrimi i tematikës

Duke studiuar të kaluarën dhe trashëgiminë e saj, fëmijët kuptojnë konceptet kyçe historike si; kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia, lidhjet shkak- pasojë, shumëllojshmëria kulturore etnike dhe fetare, rëndësia dhe perspektiva, fillimisht nëpërmjet njohjes dhe kuptimit të historisë personale dhe familjare, historisë së shkollës, historisë së zonës, rajonit për t'u zgjeruar më pas në njohjen dhe kuptimin e historisë së vendit dhe atë të qytetërimeve botërore. Kuptimi i kronologjisë aftëson fëmijët të kuptojnë vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe marrëdhënien shkak-pasojë. Fëmijët kuptojnë rolin e kohës në ndryshueshmërinë e njerëzve, shoqërisë dhe mjedisit, duke njohur disa nga ndryshimet më të rëndësishme që kanë ndodhur, duke filluar nga elementet e jetës së përditshme e deri në ndryshimet shoqërore, ekonomike, kulturore, që kanë formësuar botën.

Fëmijët zhvillojnë kuptimin për konceptin e vendit, hapësirës, ndërvarësisë midis vendeve dhe njerëzve. Përmes vëzhgimeve në vende të njohura (kryesisht në mjedisin e afërt), fëmijët eksplorojnë tipare të këtyre vendeve dhe veprimtarive që zhvillohen në to. Fëmijët identifikojnë tipare thelbësore të këtyre vendeve, kuptojnë dhe përshkruajnë pse këto vende janë të veçanta për to dhe zhvillojnë kujdesin për mjedisin.

Njohuritë

Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi për:

- ndërvarësinë në shoqëri;
- ndërvarësinë me mjedisin;
- përgjegjësinë për mjedisin dhe shoqërinë.



Shkathësitë

Fëmija:

- identifikon kopshtin/shkollën dhe qytetin ku jeton;
- eksploron (vëzhgon) tipare të mjedisve të afërta (p.sh., mjedisit/lagjes ku jeton) dhe të largëta (p.sh., një vend ku ka kaluar pushimet);
- përshkruan mjedisin (komunitetin) ku jeton, aktivitetet që mund të kryhen dhe detyrat si pjesëtar komuniteti;
- përshkruan aktivitetet që kryen përgjatë pushimeve;
- identifikon të përbashkëtat dhe të veçantat midis aktiviteteve që mund të kryejë në shtëpi dhe përgjatë pushimeve;
- identifikon çfarë e bën një vend të veçantë (p.sh., një park, një lumë etj);
- përshkruan si njerëzit mund të kujdesen për vende të ndryshme;
- identifikon tokën dhe ujin në hartë dhe glob;
- diskuton mbi rëndësinë e kujdesit për ajrin, tokën dhe ujin;
- ndjen rëndësinë e marrëdhënieve me të tjerët;
- tregon kujdes për mjedisin ku jeton;
- dënon rastet dhe sjelljet e gabuara në shoqëri dhe në mjedis;
- përshkruan disa nga cilësitë që duhet të ketë shoku, të cilat ushqejnë miqësinë dhe marrëdhëniet pozitive.

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- demonstroi kuriozitet për vendet dhe njerëzit që jetojnë në to;



- shfaq interes për të tjerët, idetë dhe interesat e tyre;
- ndan përvojat me fëmijët e tjerë;
- tregon kujdes për mjedisin;
- shpreh mendimin personal;
- gjen shkakun dhe pasojën në një situatë të dhënë;
- mban përgjegjësi për veprimet që kryen.

4.2.5 Tematika: Pushteti, autoriteti, qeverisja

Përshkrimi i tematikës

Përmes kësaj tematike, fëmijët fitojnë dije dhe ndërtojnë njohuri për rregullat e jetës kolektive e kushtet demokratike për zbatimin e tyre, si dhe për mundësitë që ekzistojnë në një shoqëri demokratike në të gjitha nivelet e jetës politike. Ata ndërtojnë njohuri për institucionet publike demokratike dhe për rregullat e lirisë dhe të vepruarit dhe ndërgjegjësohen që ndërtimi i institucioneve demokratike dhe gëzimi i këtyre lirive, janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve.

Njohuritë

Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi për:

- të drejtat e fëmijëve;
- rregullat në shtëpi, shkollë, rrugë, lojë;
- detyrat dhe përgjegjësitë;



- menazhimi i konflikteve dhe zgjidhja e tyre paqësore;
- roli i individit në familje, shkollë e shoqëri;
- punët në familje.

Shkathtësitë

Fëmija:

- përshkruan disa ndër të drejtat e fëmijëve;
- përshkruan rregulla në familje dhe në kopsht;
- përshkruan nevojën e vendosjes dhe zbatimit të rregullave;
- merr pjesë në hartimin e rregullave në klasë dhe parashikon pasoja të shkeljes së rregullave;
- rendit disa rregulla të lojës që ai zbaton në mjedisin ku jeton, luan, mëson;
- zbaton rregullat e ecjes në rrugë;
- zbaton rregullat që lidhen me sigurinë në shtëpi, shkollë, rrugë dhe këndin e lojërave;
- parandalon sjellje dhe veprime agresive;
- vendos rregulla të thjeshta, në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij të përditshme;
- zbaton shprehitë kryesore të nevojshme për përdorimin e rrugës edhe në rastet kur është i shoqëruar nga një i rritur ose nga një fëmijë më i madh;
- tregon domethënien e disa prej tabelave kryesore sinjalistike që vendosen në rrugë.

Vlerat dhe qëndrimet



Fëmija:

- gjen mënyrën e duhur për të zgjidhur një situatë konfliktuale;
- tregohet i gatshëm për të zbatuar rregullat e vendosura;
- ndien përgjegjësi në hartimin e rregullores së klasës;
- dënon rastet e shkeljes së rregullave dhe personat përgjegjës.

4.2.6 Tematika: Proceset shoqërore

Përshkrimi i tematikës

Proceset shoqërore përfshijnë zhvillimet dhe ndryshimet që ndodhin në jetën shoqërore, në mjedisin ku jeton, në nivel vendor, rajonal dhe global. Këto procese ndodhin në të gjitha fushat e jetës dhe të veprimtarisë shoqërore (fusha ekonomike, politike, shoqërore, ligjore, kulturore etj.) dhe në korrelacion me njëra-tjetrën, ndikojnë jetën tonë dhe të shoqërisë. Njohja e këtyre proceseve, e ligjshmërisë dhe e lidhjeve shkak-pasojë është domosdoshmëri për vendimmarrjet tona dhe për shkallën tonë të lirisë në këtë proces vendimmarrjeje.

Vetëm në këtë bazë, pjesëmarrja qytetare do të jetë e përgjegjshme, e vetëdijshme, aktive dhe e orientuar nga e ardhmja dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Njohuritë

Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi për:

- ngjarje të caktuara shoqërore, kulturore dhe historike;



- ndryshimet që ka pësuar komuniteti ku jeton;
- lidhjen e figurave të shquara me një atribut të caktuar në kohë të caktuar;
- muzeumet historike dhe etnografike.

Shkathtësitë

Fëmija:

- merr pjesë aktive në ngjarje të rëndësishme për bashkëmoshatarët e tyre;
- vlerëson figurat e shquara historike;
- përshkruan si jetojnë dhe si punojnë njerëzit në komunitet.

Qëndrimet dhe vlerat

Fëmija:

- merr pjesë aktive në ngjarje të rëndësishme për bashkëmoshatarët e tyre;
- vlerëson figurat e shquara historike.



4.2.7 Tematika: Prodhimi, konsumi, shpërndarja

Përshkrimi i tematikës

Nëpërmjet kësaj tematike fëmijët fitojnë njohuri për mënyrën si njerëzit organizojnë prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e të mirave e të shërbimeve dhe njihen e kuptojnë çështjet themelore, që lidhen me vendimet në fushën e veprimtarisë ekonomike. Ata njihen me koncepte të thjeshta, por kryesore, ekonomike dhe rëndësinë që ka njohja e tyre për jetën e tij dhe të shoqërisë.

Njohuritë

Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi për:

- dëshirat dhe nevojat;
- zgjedhjen e duhur;
- profesionet e prindërve;
- të ardhurat në familje;
- paranë, kursimin, përdorimin;
- arkën e kursimit;
- dhuratat për ditëlindjen;
- shërbimet që ofron komuniteti.

Shkathtësitë

Fëmija:



- dallon që njerëzit kanë nevoja bazë (p.sh., për ushqim, strehim, veshje, etj.) dhe dëshira (p.sh., për t'u argëtuar etj).
- bën dallimin ndërmjet nevojave dhe dëshirave;
- flet për rëndësinë që kanë për të ushqimi, veshja, banesa, familja, lojërat, dashuria dhe respekti, librat, siguria etj.;
- përshkruan punët që bëjnë njerëzit e familjes për të siguruar paratë;
- identifikon profesione që kryejnë pjesëtarët e familjes;
- përshkruan lloje të ndryshme profesionesh dhe parashikon se çfarë mund të bëhet kur të rritet;
- identifikon monedhën e vendit;
- tregon se si familjet i përdorin paratë për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e tyre;
- dallon disa nga shërbimet për të cilat njerëzit kanë nevojë në lagjen ku banojnë;
- dallon disa nga institucionet që mund të ofrojnë shërbime për komunitetin ku jeton (për shembull, tregon se çfarë shërbimesh mund ofrojnë ambulanca, policia, zjarrfikësja etj.);
- tregon se çfarë mund dhe duhet të bëjnë fëmijët dhe banorët e tjerë të komunitetit për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe të përfitimit prej tyre;
- përshkruan kufizimet që mund të kenë për shkak se duhet të zgjedhin (p.sh., si vendosin çfarë të blejnë në dyqan, si i bëjnë zgjedhjet).

Vlerat dhe qëndrimet

Fëmija:

- respekton profesionet dhe shërbimet e ndryshme që kryhen në shoqëri;
- shfaq respekt për njerëzit që punojnë;
- vlerëson përpjekjet që bëjnë prindërit për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e fëmijëve;



- justifikon me raste konkrete pse nevojat e familjes janë mbi dëshirat personale të fëmijëve;
- pranon rëndësinë e pjesëmarrjes së tij në komunitet.

4.3 Materialet dhe mjetet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në fushën shoqëria dhe mjedisi ndihmon në konkretizimin e ideve dhe të dukurive, si dhe e bën veprimtarinë mësimore më interesante dhe më argëtuese për fëmijët. Mjetet e nevojshme didaktike mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma me karakter didaktik, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.



FUSHA “EDUKIMIT FIZIK, SPORTE DHE SHËNDET”

PROGRAMI I EDUKIMIT FIZIK, SPORTE DHE SHËNDET

5.1 Hyrje

Kjo fushë u jep mundësi fëmijëve të fitojnë kompetenca për ruajtjen e shëndetit të tyre dhe të të tjerëve, respektin për veten dhe ruajtjen e organizmit nga dëmtimet e mundshme gjatë të ushtruarit në një aktivitet fizik e sportiv.

Aktiviteti fizik i ndihmon fëmijët për të përmirësuar mundësitë fizike, aftësitë koordinative, si dhe zhvillimin e aftësive personale dhe ndërpersonale, të cilat ndikojnë në rritjen e mirëqenies së tyre fizike dhe në sigurimin e një jete aktive dhe të shëndetshme. Gjithashtu, fëmijët zhvillojnë kapacitete motorike, edukojnë cilësi njohëse dhe edukative me anë të lojërave të ndryshme parasportive.

Kompetencat e fushës

Bazuar në këtë kurrikul, fusha “Edukimi fizik, sporte dhe shëndet” synon të përmbushë 3 kompetenca:

- Shfaqja e aftësive lëvizore në përshtatje me situata të ndryshme lëvizore e sportive
- Ndërveprimi me të tjerët në situata të ndryshme lëvizore e sportive
- Përshtatja me një një stil jete aktive e të shëndetshme



5.2 Përmbajtja lëndore

5.2.1 Tematika: Edukim nëpërmjet aktiviteteve fizike

Përshkrimi i tematikës

Edukimi, nëpërmjet aktiviteteve fizike, u afron nxënësve një platformë nga e cila mund të ndërtojnë kompetenca për të përmirësuar kapacitetet fizike e aftësitë koordinative, si dhe i ndihmon ata në zhvillimin e aftësive personale dhe ndërpersonale. Kjo tematikë u mundëson nxënësve të zhvillojnë konceptet dhe aftësitë e nevojshme për pjesëmarrje në një gamë të gjerë të aktiviteteve fizike e sportive, të cilat ndikojnë në rritjen e mirëqenies fizike të tyre dhe i përgatit për një jetë aktive dhe të shëndetshme. Kjo tematikë fokusohet kryesisht në lojëra dhe veprimtari lëvizore të cilat kanë në përmbajtje të tyre lëvizje lokomotore, jolokomotore dhe manipulative.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

- kryen lëvizje të ndryshme të pjesëve të ndryshme të trupit;
- kryen lëvizjeve jolokomotore (tërheqje, shtytje, ekuilibrim, kthim, rrotullim etj.) dhe lokomotore (ecje, vrapim, kërcim etj.);
- demonstroi aftësi të përshtatjes të lojërave të reja lëvizore.

Njohuritë

▪ Lojëra lëvizore e popullore:

- Lojëra lëvizore: “Gjigandi dhe shkurtabiqi”, “Zëre vendin sa më shpejt – Loja me karrige”, “Loja me stafeta”, “Loja me shami”



- Lojëra popullore (tradicionale): “Macja kapi miun”, “E ka kush e ka”, “Hapa-dollapa”, “Gjilpëra, peri, nyja”, “Çova një letër mu në postë”, “Rrjeta dhe peshqit”, Rregulla të lojës.

- **Gjmnastikë:**

- Lëvizje manipulative me trup të lirë;
- Rrokullisje me trup të lirë në tokë.

- **Atletikë:**

- Ecje sipas vijave dhe figurave;
- Ecje ndërmjet objekteve;
- Vrapime me ndryshim drejtimi dhe shpejtësie;
- Kërcime në forma të ndryshme;
- Goditje në shenjë.

Shkathtësitë

Fëmija:

- përfshihet në lojërat që zhvillohen në grup duke respektuar rregullat e tyre;
- tregohet i vëmendshëm gjatë zhvillimit të lojës;
- bashkëvepron gjatë lojërave në grup dhe tregon shenjat e para të sjelljes sportive;



- kryen skema të thjeshta lëvizore;
- ngjit dhe zbret shkallët, duke alternuar këmbët;
- koordinon pjesët e trupit sipas lëvizjeve që bën;
- ecën dhe vrapon rreth pengesave, objekteve;
- kërcen me dy këmbë mbi objekte të vogla duke ruajtur ekuilibrin;
- kapërcen pengesa, zvarritet, ecën në një tra të ulët ekuilibri, ngjit dhe zbret shkallët duke alternuar këmbët (një këmbë për një shkallë);
- bën kapërdimje për t'u hedhur e për t'u rrotulluar;
- pozicionon trupin në përshtatje me veprimet që kryen;
- kryen kërcime individuale me litar;
- kryen veprimin lëvizor të ecjes (zhvendosjes): *para, mbrapa, anash; shpejt, ngadalë; zig-zag, këmba-doraz; midis objekteve dhe mbi objekte;*
- kryen veprimin lëvizor të vrapimit me *ndryshim drejtimi dhe shpejtësie;*
- kryen veprimin lëvizor të kërcimit me dy këmbë: *pupthi, lart, së gjati;*
- kryen veprimin lëvizor të goditjes në shenjë: *gjuajtje me top në objekte të fiksuara, rrëzimi i shisheve/ birilave.*
- menazhon emocionet vetjake si në rastin e fitores edhe në rastin e humbjes së lojës/ garës.



5.2.2 Tematika: Aktivitete parasportive

Përshkrimi i tematikës

Kjo tematikë, ka për qëllim t'u japë mundësi nxënësve të aplikojnë në lojëra parasportive veprimet lëvizore të mësuara në linjat e tjera të programit, të njihen me rregullat e lojërave, të njihen me teknikat fillestare të disa prej elementeve bazë të lojërave (pasim, gjuajtje, goditje), të zhvillojnë kapacitetet motorike dhe të edukojnë cilësi njohëse e edukative. Gjithashtu kjo tematikë nëpërmjet nëntematikës “Veprimtari sportive ndihmëse (opsionale)”, ka për qëllim t'u japë mundësi nxënësve të kryejnë një aktivitet më të plotë fizik, në përshtatje me kushtet që shkolla afron për sa i përket infrastrukturës, vendosjes gjeografike dhe kushteve klimaterike, si dhe traditës sportive të shkollës (apo qytetit). Referuar kësaj nëntematike, në këtë klasë sugjerohet marshimi në natyrë.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

- zbaton kombinime të ndryshme lëvizore referuar situatave të ndryshme të lojërave të ndryshme para sportive;
- zbaton rregulla të thjeshtuara në lojëra të ndryshme;
- demonstroi aftësi bashkëpunimi me partnerin dhe respekti ndaj kundërshtarit në lojë;
- demonstroi metoda të përshtatshme të kryerjes së aktivitetit (marshimit) në natyrë;
- demonstroi aftësi të orientimit në natyrë duke vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me të.

Njohuritë

- **Lojëra parasportive të basketbollit, volejbollit dhe futbollit:** “Hedhje dhe pritje topi me dy duar”, “Gjuajtje në shenjë”, “Pasim topi”, “Hedhje topi/ disku në largësi”.



- **Veprimtari sportive ndihmëse:** Marshim në natyrë.

Shkathtësitë

Fëmija:

- merr pjesë aktive në lojë;
- zbaton rregullat e thjeshtuara të lojës;
- ruan qetësinë gjatë lojës;
- menazhon emocionet vetjake si në rastin e fitores, ashtu edhe në rastin e humbjes së lojës/ ndeshjes;
- bashkëpunon gjatë lojës me shokët e skuadrës;
- zbaton teknikat fillestare të elementeve të pasimit të topit me dy duar dhe me këmbë;
- qëndron në pozicionin e duhur gjatë lojës;
- respekton kundërshtarët në lojë;
- i afrohet objektit gjatë gjuajtjes në shenjë.
- zbaton të paktën 3 rregulla elementare të marshimit në natyrë.

5.2.3 Tematika: Edukim në shërbim të shëndetit, mirëqenies dhe komunitetit

Përshkrimi i tematikës



Përbajtja e kësaj tematike u mundëson fëmijëve fitimin e kompetencave për ruajtjen dhe kultivimin e shëndetit të tyre, u mundëson të njohin dhe të zbulojnë respektin për veten dhe të tjerët, të njihen me forma të thjeshta të dhënies së ndihmës së parë, të bëjnë zgjedhje të shëndetshme, të zbatojnë praktika të sigurta dhe higjienike në rutinën ditore.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

- menazhon emocionet e tij/saj dhe i përshtat ato në situata të ndryshme;
- njih rregullat elementare të ruajtjes së organizmit nga dëmtimet e mundshme gjatë të ushtruarit me aktivitet fizik e sportiv;
- demonstroi përkushtim për ruajtjen dhe kultivimin e higjienës personale dhe të mjedisit në shtëpi, kopsht/shkollë dhe komunitet;
- zbaton mënyra të respektimit dhe të ruajtjes së mjedisit ku jeton.

Njohuritë

- Mirëqenie fizike, mendore, emocionale dhe sociale.
- Ruajtja e organizmit nga dëmtimet e mundshme gjatë të ushtruarit me aktivitet fizik e sportiv.
- Të ushqyerit e shëndetshëm.
- Edukimi mbi mjedisin.

Shkathësitë

Fëmija:

- kujdeset për higjienën personale: lan duart, fytyrën, qafën dhe veshët;



- mban trupin drejt për një shëndet të mirë të shtyllës kurrizore;
- përshtat veshjen me lojën/ veprimtarinë sportive që kryen;
- kryen praktikat higjieno-sanitare gjatë ngrënies, fjetjes dhe lojës;
- zbaton rregullat e sigurisë për jetën në klasë, në familje dhe në rrugë;
- kërkon të dezinfektojë plagën e shkaktuar gjatë lojës;
- konsumon produkte të shëndetshme ushqimore;
- tregon simptoma të thjeshta që shfaqen nga sëmundje të moshës, si: temperaturën, kollën, dhimbjen e barkut, të veshit, të kokës, të dhëmbit etj.;
- tregon kur ndihet i lodhur dhe kërkon të pushojë;
- merr pjesë në pastrimin dhe rregullimin e klasës, të dhomës së tyre në shtëpi, në rregullimin e lodrave, të materialeve dhe mjeteve të ndryshme.

5.3 Materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin e lojërave dhe të veprimtarive të ndryshme fizike, mësuesi duhet të përdorë një bazë të gjerë materialesh dhe mjeteve didaktike, si: topa, litarë, dyshek gjimnastikor, trarë të vegjël ekuilibri, birila, rrathë, shkopinj gjimnastikorë etj.



FUSHA ARTET

PROGRAMI I MUZIKËS

6.1 Hyrje

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme në formimin e fëmijëve nga parashkollori dhe më tej sepse përfshihen dimensione të kulturës muzikore, pamore, lëvizore, shprehëse, intelektuale dhe emocionale, mbi të cilat ndërveprojnë kultura dhe shoqëria. Kjo fushë u jep mundësi fëmijëve për t'u njohur dhe për të zhvilluar njohuritë artistike duke kuptuar si funksionojnë tingujt, ngjyrat, format, fjalët dhe lëvizjet. Të gjitha këto mësohen, formohen dhe kultivohen nëpërmjet zbulimeve konkrete nga jeta e përditshme, të cilat i provojnë dhe i përjetojnë në forma të ndryshme.

Artet janë konceptuar në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës. Nëpërmjet elementeve dhe vlerave artistike e kulturore, artet stimulojnë ndërgjegjësimin trupor, ushqejnë imagjinatën artistike, kontribuojnë në zhvillimin e vetëbesimit, ndihmojnë në krijimin dhe zhvillimin e vetëdijes dhe të identitetit kombëtar.

Kompetencat e lëndës

Bazuar në këtë kurrikul, muzika synon të ndërtojë dhe të zhvillojë 3 kompetencat e lëndës:

- Kompetenca 1. Krijimi muzikor
- Kompetenca 2. Performimi/ interpretimi muzikor
- Kompetenca 3. Vlerësimi i veprave muzikore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:



- *Krijimi muzikor*: zbulon elemente muzikore në mjedisin përreth tyre, në natyrë dhe në muzikë; identifikon burime ritmike dhe melodike (tingullore); imiton tinguj muzikorë ose jo muzikorë; improvizon modele të ndryshme ritmike ose jo ritmike, provon të improvizojë ritmin mbi një këngë apo melodi.
- *Performimi/interpretimi muzikor*: këndon dhe performon këngë dhe lojëra muzikore; shpreh emocionet e veta për këngët apo lojërat muzikore që këndon etj.
- *Vlerësimi i veprave muzikore*: shpreh mendimin e vet rreth këngës/pjesës që dëgjon; vlerëson interpretimin dhe performimin e të tjerëve; përdor një fjalor të thjeshtë muzikor.

6.2 Përmbajtja lëndore

6.2.1 Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor

Përshkrimi i tematikës:

Në këtë tematikë fëmija kërkon, zbulon burime të ndryshme të dukurive dhe fenomeneve natyrore për të kuptuar më natyrshëm gjuhën muzikore. Ai/ajo fillon t'i kuptojë këto elemente muzikore duke eksperimentuar dhe fillon t'i ndërtojë njohuritë e veta mbi dukuritë muzikore. Edukimi me ritmin dhe melodinë, fillon që në grupet e vogla ku fëmijët zbulojnë elementet tingullore dhe ritmike nga mjedisi, i provojnë dhe i përjetojnë ato në forma të ndryshme nëpërmjet dëgjimit, krijimit dhe këndimit.

Njohuritë

- **Ritmi dhe burimet e tij:**

- Nga mjedisi përreth.
- Në natyrë.



- Karakteristikat e ritmit.

▪ **Tingujt dhe burimet e tyre:**

- Tingujt në mjedisin përreth.

- Tingujt në natyrë.

- Tingujt në muzikë.

- Karakteristikat e tingullit.

Shkathtësitë

Fëmija:

- përjeton ritmin e prodhuar nga burime ritmike në mjedisin rrethues, si: çak-çak-goditja e çekiçit, tik-tak – rrahja e orës etj.

- përjeton ritmin e prodhuar nga burime ritmike në natyrë: troku i kalit trak-trok, kuak-kuak-un e bretkosës, mjaullimën e macës mjau-mjau etj.

- imiton goditjet ritmike që dallon në natyrë dhe në mjedisin rrethues.

- krijon modele ritmike duke përdorur mjetet trupore *shuplakat dhe këmbët dhe objekte* të ndryshme me goditje.

- nxjerr tinguj të ndryshëm duke luajtur me *zërin*.

- dallon tinguj që prodhohen në natyrë, si: cicërima e zogut, lehja e qenit, fëshfërima e gjetheve, gurgullima e ujit etj.

- dallon tinguj që ndeshen në mjedisin rrethues, si: boria e makinës, zilja e shkollës, zërin e prindërve, të shokëve etj.

- imiton tingujt, zhurmat, zërat e ndryshëm, rrahjet që dëgjon në mjedisin përreth.



- dallon tingujt që lëshojnë të paktën 2-3 vegla muzikore.
- jep disa karakteristika të tingujve që dëgjon, si: i trashë, i hollë, i lartë, i ëmbël etj.

6.2.2 Tematika: Teknika dhe procese muzikore

Përshkrimi i tematikës

Proceset muzikore që zhvillohen dhe përshkojnë muzikën në tërësi janë: këndimi, luajtja me instrumente muzikore për fëmijë, përjetimi, interpretimi, dëgjimi muzikor, krijimi, improvizimi, analizimi të cilat zhvillohen nëpërmjet teknikave të ndryshme të të kënduarit, luajtjes në instrument, të dëgjuarit etj. Përmbajtja e këngëve për fëmijë ka një tematikë të caktuar: himni, atdheu, familja, shoqëria, këngët patriotike dhe festat e ndryshme etj., si dhe këngë/lojë muzikore dhe rituale popullore. Ato janë didaktike dhe kanë vlera artistike muzikore - poetike, të cilat edukojnë për një qëllim të caktuar.

Këngët duhet të jenë të thjeshta për nga shtrirja e regjistrit vokal (zërit), melodia dhe ritmi. Kryesisht tematika zhvillohet nëpërmjet procesit të këndimit dhe shoqërimit të këngëve me instrumente për fëmijë (kryesisht me goditje).

Procesi i këndimit zhvillohet nëpërmjet mësimit të këndimit thjeshtë, pastër dhe me emocion apo të një kënduari të saktë në intonacion e ritëm, ndërsa procesi i shoqërimit me instrumente fëmijore me goditje zhvillohet nëpërmjet mësimit të përjetimit ritmik dhe shoqërimit të saktë gjatë përdorimit të tyre. Instrumentet trupore, instrumentet me goditje dhe ORF, do të jenë pjesë e shoqërimit të këngëve dhe improvizimit me to, apo të muzikës që fëmijët këndojnë, vallëzojnë dhe luajnë.

Njohuritë



Aparati i vokalit: Ndërtimi i aparatit vokal të njeriut.

Këngë për fëmijë.

Rregullat e këndimit.

Këndimi solo dhe në grup.

Lojëra muzikore:Të thjeshta për fëmijë.

Mjetet trupore: Duartrokitje të shuplakave. Duartrokitje të shuplakave mbi gjunjë. Përplasja e këmbëve.

Instrumentet e perkusionit: Tamburi. Shkopinjë. Zilka/këmbora. Trekëndëshi.

Shkathtësitë

Fëmija:

- këndon solo dhe në grup;
- këndon këngë të thjeshta dhe të njohura për fëmijë;
- zbaton rregullat e këndimit: hapja e gojës, frymëmarrja, intonimi, qëndrimi, shqiptimi;
- këndon dhe shoqëron me lëvizje trupore melodinë e këngës gjatë këndimit;
- realizon lojën muzikore apo ritualin popullor sipas koreografisë së caktuar nga mësuesi;
- shoqëron këngët, lojërat muzikore apo ritualet popullore a) me lëvizje, b) me mjete trupore ose c) me instrumente me goditje;
- improvizon me ritmin me dy dhe katër goditje;



- imiton me zërin e vet tinguj të ndryshëm që dëgjon, duke iu përafuar origjinalit;
- imiton karakteristikat e tingujve që dëgjon;
- shpjegon tingujt dhe ritmet që dëgjon;
- përdor/sajon instrumente të thjeshta muzikore;
- prodhon ritme dhe tinguj me mjete rrethore ose instrumente të ndërtuara nga vetë ata.

6.2.3 Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria

Përshkrimi i tematikës

Mendimi muzikor është një element shumë i rëndësishëm i cili shprehet përmes emocioneve njerëzore. Edhe muzika krijon emocione, që shprehin: dashuri, kënaqësi, keqardhje, gëzim, shpresë, mërzi. Edukimi përmes dëgjimit muzikor të këngëve apo pjesëve të ndryshme muzikore kultivon tek fëmijët dëshirën për muzikën, përqëndrimin për ta dëgjuar me kënaqësi dhe i bën ata të vetëdijshëm ndaj muzikës që ata dëgjojnë.

Fragmente të vogla muzikore të huaja dhe shqiptare, përveçse krijojnë emocione të ndryshme tek ata, i ndihmon të kuptojnë gjuhën muzikore, të shprehen bukur dhe të vlerësojnë karakteristikat e ritmit, të tingujve, ngjyimit, dinamikës duke përdorur fjalë të thjeshta. Gjithashtu, pjesë të ndryshme muzikore i vendosin fëmijët të zhvillojnë më tej botën e krijimit dhe të shprehjes, ata njohin kompozitorë të ndryshëm, pasurojnë njohuritë e tyre të përgjithshme të kulturës dhe njihen me shumëllojshmërinë e krijimeve artistike nga e kaluara dhe e tashmja, nga vendi dhe bota.

Njohuritë



Muzika dhe emocioni përmes dëgjimit muzikor. Muzika shpreh: dashuri, kënaqësi, keqardhje, gëzim, shpresë, mërzitje etj.

Pjesë muzikore për dëgjim: Këngë dhe lojëra për fëmijë

Shkathtësitë

Fëmija:

- zbulon tinguj, zhurma, goditje në mjedisin përreth dhe thotë si ndjehet;
- dallon nëse ritmi i muzikës është i shpejtë ose i ngadaltë;
- imiton tingujt, zhurmat, zërat e ndryshëm, rrahjet që dëgjon në mjedisin përreth;
- komenton me fjalë të thjeshta këngët që dëgjon;
- shpreh emocionet për këngët dhe lojërat muzikore që këndon apo dëgjon;
- përdor simbole të ndryshme grafike, për të shprehur gjendje të ndryshme emocionale nga muzika e dëgjuar;

6.3 Materiale dhe mjete mësimore

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- mjetet pamore natyrore si: objektet natyrore që shërbejnë për të demonstruar tinguj, zhurma etj.
- mjetet audiovizive si: Tv, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- mjetet dëgjimore: radio, magnetofon, kasetofon etj.
- mjetet verbale, si: albume, fletë pune didaktike etj.



PROGRAMI I ARTIT PAMOR

7.1 Hyrje

Arti është shumë i natyrshëm në jetën e fëmijëve, ashtu siç janë gjuha dhe loja. Arti pamor aftëson fëmijët në zgjidhjen e problemeve, në zhvillimin e mendimit kritik, gjithashtu i ndihmon ata në zhvillimin gjuhësor dhe komunikimin, në matematikë si dhe në shoqërizim. Arti pamor është një gjuhë e përbashkët për të gjithë fëmijët. Edukimi nëpërmjet artit është një mundësi e mirë për të përmirësuar komunikimin midis fëmijëve me prejardhje kulturore dhe social-ekonomike të ndryshme dhe me aftësi të ndryshme.

Fëmijët e parashkollorit kanë një tërheqje të natyrshme ndaj procesit të krijimit në artin pamor. Vizatimi i shenjave, punimi i plastelinës, përdorimi i penelave për të ngjyrosur janë veprimtari që i tërheqin shumë fëmijët e vegjël. Fëmijët e vegjël janë nga vetë natyra e tyre krijues. Lënda e artit pamor i nxit fëmijët në procesin krijues nëpërmjet përdorimit të materialeve të shumëllojshme. Programi i artit pamor për këtë moshë nuk është i fokusuar në inkurajimin e fëmijëve për të prodhuar, për shembull, një pikturë të veçantë, por më tepër për t'u ushtruar duke përdorur një penel në letër, pa një rezultat të caktuar. Kjo pikërisht mbështetet në faktin se përvoja artistike për parashkollorët është e lidhur më shumë me procesin sesa me produktin artistik. Lënda e artit pamor gjithashtu është motivuese dhe mbështet të nxënësit në të gjitha fushat në kurrikul. Arti mund të jetë një mjet efektiv përmes të cilit zhvillohen aftësi të rëndësishme të fëmijët e kësaj moshe të tilla si ndjeshmëria, bashkëpunimi, kurioziteti mbi njohuritë gjuhësore dhe dallimet kulturore, zgjerimi i fjalorit dhe kuptimi i simboleve ose koncepte matematikore të tilla si numrat, madhësia dhe forma. Arti pamor është një mjet për të zbuluar, për të komunikuar, për të shprehur zgjedhjet personale dhe për të përcaktuar stadin e zhvillimit dhe aftësitë e fëmijëve.

Kompetencat e lëndës

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e artit pamor synon të përmbushë 3 kompetencat e lëndës:



Kompetenca 1. Krijimi artistik

Kompetenca 2. Realizimi i punimit

Kompetenca 3. Vlerësimi i veprave të artit

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi artistik:** përdor elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; identifikon këto elemente të artit pamor në mjedisin që e rrethon apo në vepra arti; përfundon krijimin e tij/saj.
- **Realizimi i punimit:** përdor teknikat artistike dhe elementet e artit pamor.
- **Vlerësimi artistik:** dallon elementet e përmbajtjes në vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore, në krijimet e veta dhe të të tjerëve

7.2 Përmbajtja lëndore

7.2.1 Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik

Përshkrimi i tematikës

Fëmija krijon punë dy dhe tri dimensionale duke përdorur teknika të ndryshme artistike. Ai/ajo përdor një sërë stimuljsh në përshtatje me moshën për krijimet që realizon. Fëmija krijon duke u mbështetur tek eksperiencia, vëzhgimi dhe imagjinata, në mënyrë individuale, por ndonjëherë edhe në grup. Fëmija inkurajohet të reflektojë mbi përvojat krijuese dhe ta ndajë me të tjerët këtë përvojë.



Njohuritë

- **Vija:** e hollë, e trashë
- **Forma dy dimensionale:** Forma natyrale. Forma gjeometrike.
- **Ngjyrat :** Ngjyrat primare (parësore): e verdhë, e kuqe (magenta), blu (cian); Ngjyrat sekondare (dytësore): jeshile, portokalli, lejla.
- **Tekstura:** Materiale me tekstura të ndryshme
- **Motivi:** Motive të ndryshme
- **Forma tre dimensionale:** Format tre dimensionale
- **Organizimi i hapësirës (parimet):** Përsëritja, krahasimi

Shkathtësitë për të tria grupet

- Dallon vijën në natyrë dhe mjedisin përreth.
- Vizaton figura dhe objekte të njohura për të, nëpërmjet vijës, duke përdorur mjete të ndryshme: laps, shkumës, stilolaps, pastel, lapustil.
- Dallon format natyrale dhe gjeometrike në natyrë dhe mjedisin që e rrethon.
- Përdor format gjeometrike dhe natyrale në krijimin e vet.
- Dallon ngjyrat në natyrë dhe mjedisin që e rrethon.
- Përdor ngjyrat në krijim me lapsa me ngjyra, penela dhe tempera.
- Përdor materiale me tekstura të ndryshme: letra, karton, pëlhurë etj.
- Vizaton motive të ndryshme në krijim: retë në qiell, vijëzime etj.



- Ndërton forma tri dimensionale me plastelinë, letër, karton dhe konstruksione.
- Përsërit dhe krahason motivin në një stampim.

7.2.2 Tematika: Teknika dhe procese artistike

Përshkrimi i tematikës

Fëmija krijon punë dy dhe tri dimensionale duke përdorur teknika të ndryshme artistike dhe një sërë stimuljsh në përshtatje me moshën. Ndjekja e procesit të realizimit është pjesë e rëndësishme e krijimtarisë. Eksperiencat, vëzhgimi dhe imagjinata e fëmijës janë pjesë e rëndësishme e procesit krijues. Fëmija krijon nga kujtesa, vëzhgimi dhe imagjinata, në mënyrë individuale, por ndonjëherë edhe në grup. Fëmija nxitet të reflektojë mbi përvojat e tij krijuese dhe për të folur mbi aspekte që janë të rëndësishme për të.

Njohuritë

- **Vizatimi:** Mjete të ndryshme si: laps, lapustil, shkumës, pastel, stilolaps.
- **Piktura:** Bojëra uji në kuti (guash, tempera) me ndihmën e penelave të sheshtë, lapsa, lapustila, letra me ngjyra.
- **Stampimi:** Përdor objekte të ndryshme me tempera (guash) mbi letër: monotipi me bojëra guashi.
- **Kolazh– procesi:** Grisja, prerja, ngjitja e letrës dhe kartonit mbi një sipërfaqe
- **Modelimi me plastelinë**
- **Konstruksioni - objekte me volum:** Kuba prej kartoni, letër dhe lojëra konstruksioni prej druri dhe plastike.

Shkathtësitë: Fëmija:

- eksperimenton me mjete dhe materiale të ndryshme të vizatimit, pikturës, skulpturës, konstruksioneve;



- i përdor mjetet e vizatimit e të pikturës në formate letrash me sipërfaqe të ndryshme;
- vizaton dhe ngjyros duke u mbështetur në përvojat personale, në jetën e përditshme dhe në historitë e dëgjua/të lexuara, që kanë lidhje me shtëpinë, lodrat, ëndrrat, dëshirat, personazhet, festat, rastet e veçanta etj.;
- eksperimenton me stampa të thjeshta (me objekte që kanë teksturë dhe formë interesante);
- përdor një ose dy ngjyra për t'u fokusuar te tekstura, forma dhe motive;
- shfrytëzon mundësitë e modelimit me plastelinë (shtyp, tërheq, ndan, shpon e copëton plastelinën në copa dhe e bashkon përsëri; fillon të bëjë dallimin midis formave të sheshta dhe atyre solide që qëndrojnë në këmbë);
- dallon cilësitë e materialeve të ndryshme dhe aftësohet në përdorimin e tyre në punën e tij, nëpërmjet prerjes me gërrshërë, grisjes dhe ngjitjes mbi një sipërfaqe.
- krijon forma të thjeshta me plastelinë;
- eksperimenton me materialet që përdoren për konstruksione (grupon, ndërton me pjesë të vogla dhe lodra konstruksioni).
- dallon pjesët më të gjata, më të shkurtra, më të larta, më të ulëta të strukturës që ka krijuar.
- riorganizon strukturën e krijuar.



7.2.3 Tematika: Historia, arti dhe shoqëria

Përshkrimi i tematikës

Fëmija merr pjesë në aktivitete të shkurtra, në të cilat ai vëzhgon vepra arti nga e shkuara, e tashmja dhe nga kultura të ndryshme, duke përfshirë edhe krijimet e tij dhe të shokëve/shoqeve të klasës. Përmbajtja e veprave të artit, të paraqitura nëpërmjet posterave apo në rrugë elektronike audio vizuale, duhet të jetë e përshtatshme për eksperiencën kulturore të kësaj grupmoshe. Ato janë shumë të rëndësishme si kritere të paracaktuara të vëzhgimit në lidhje me zhvillimin e stimulimit të krijimit, me teknikat artistike, studimit të elementeve të artit, po aq sa të emocioneve dhe përshtypjeve.

Njohuritë

- **Histori Arti:**

- *Vepra¹ të ndryshme* arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme në përshtatje me temën mësimore.
- Objekte tradicionale kulturore.
- Imazhe fotografike.

- **Eksperiencia artistike:** Vizita në studiot e artistëve, punishtet e artizanëve të zonës.

- **Ekspozita dhe evente kulturore:** Vizita në muzeume, galeri arti, Ekspozita me punimet e fëmijëve

1

Veprat e artit përzgjidhen në përshtatje me njohuritë dhe konceptet vizuale që përmban programi.



Shkathësitë

Fëmija:

- identifikon objekte apo personazhe të njohura nga fotografitë, ilustrimet apo nga vepra arti;
- dallon materialet që janë përdorur në punim;
- vendos titullin e punimit dhe e shpjegon atë;
- komenton me një fjalor të thjeshtë punën e vet dhe të të tjerëve;
- vëzhgon me kuriozitet veprat e artit dhe objekte të ndryshme artizanati;
- përshkruan atë që sheh në një vepër arti, objekt të njohur artizanati dhe fotografi;
- identifikon ngjyra dhe forma të përdorura në një vepër arti;
- tregon pjesën që pëlqen më shumë;
- zbulon disa profesione që lidhen me artin (artist, artizan, piktor, skulptor);
- viziton një ekspozitë në muze, galeri arti ose qendër kulturore dhe shpreh mbresa rreth saj;
- merr pjesë në ekspozimin e punimeve në klasë.

7.3 Materiale dhe mjete mësimore

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- fotografi të ndryshme që mbajnë informacionin e duhur për eksplorimin e elementeve të artit në natyrë dhe mjedisin rrethues;
- fotografi të objekteve të ndryshme të artizanatit, të trashëgimisë kulturore etj.;



- riprodhime të veprave të artit dhe postera;
- mjetet audiovizive si: TV, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD;
- mjetet verbale, tekstet si: katalogë, albume, fletë pune didaktike etj.



PROGRAMI I TEATRIT

8.1 Hyrje

Teatri është një nga artet më të vjetra në botë. Njeriu ka një nevojë të brendshme për të shkuar tek teatri, ai ka nevojë të krijojë art me trupin e zërin e tij dhe të shpërndajë mesazhe përmes fjalës së përpunuar artistike. Njohja e teatrit mbart një vlerë të madhe në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve, të aftësisë së tyre për të punuar në grup, për të folur në mënyrë të denjë në publik dhe për të zhvilluar prirjet e tyre artistike e krijuese.

Veprimtaritë e ndryshme teatrore e çojnë fëmijën të interpretojë teknikisht e me shije materiale të ndryshme letrare, të përdorë aftësitë e tij fizike e krijuese për të përcjellë mesazhe, për të krijuar karaktere dhe realitete artistike. Duke e përjetuar teatrin nga vetë skena, ai do të fillojë të vlerësojë edhe më mirë këtë lloj gjinie dhe *kënaqësinë* që marrim prej teatrit.

Në programin e teatrit fëmija mëson të eksperimentojë interpretimin nëpërmjet trupit dhe zërit të vet, hulumton punën në grup dhe kupton rëndësinë e ndërvartësisë nga njëri-tjetri. Ai kupton dhe argumenton qëndrimet e veta, duke ua paraqitur të tjerëve, mësohet të vlerësojë e të respektojë edhe qëndrimet e të tjerëve, arrin të krijojë siguri në komunikimin publik dhe të jetë bindës, ndihet i suksesshëm në teatër.

Kompetencat që formohen përmes tematikave

Kompetenca 1: Krijimi i veprave teatrore.

Kompetenca 2: Performimi/interpretimi i veprave teatrore.

Kompetenca teatrore 3: Vlerësimi i veprave teatrore.



Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi i veprave teatrore:** Zbulon dhe identifikon elementet teatrore, zgjedh nga format e ofruara të interpretimit (kukulla, hije, kostume), demonstroi interpretimin gjatë improvizimit dhe krijimit të modeleve interpretuese.
- **Performimi/interpretimi i veprave teatrore:** interpreton me elemente të gjuhës teatrore, respekton konvencionin, sillet sipas rolit, krijon në varësi të rrethanës e personazhit, improvizon nëpërmjet trupit të tij.
- **Vlerësimi i veprave teatrore:** flet qartë duke përdorur elementet teatrore gjatë shpjegimit të interpretimit; fillon të përdorë një fjalor të thjeshtë artistik; shpjegon me fjalë të thjeshta përjetimet e interpretimit.

8.2 Përmbajtja lëndore

Në programin e lëndës së teatrit janë paraqitur përmbajtjet e tematikave të teatrit:

- *Gjuha dhe komunikimi teatror;*
- *Teknikat dhe proceset e interpretimit;*
- *Historia, teatri dhe shoqëria.*

Tematikat dhe renditja e tyre nuk supozojnë paraprakisht që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave dhe në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e koncepteve dhe shprehive teatrore në situata të nxëni, grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e mësuesit

REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE SIPAS TEMATIKAVE

8.2.1 Tematika : Gjuha dhe komunikimi teatror



Përshkrimi i tematikës:

Fëmijët luajnë gjatë gjithë kohës: shkollash, shtëpiash, spitalesh, restorantesh, sylla-mbylla, etj. Gjatë lojës ata besojnë me gjithë shpirtin në personazhin që u është caktuar ose kanë zgjedhur. Për këtë arsye fëmijët janë nga natyra një shembull për aktorët e rritur sepse një aktor duhet të mësojë të besojë në rolin e tij, sikurse një fëmijë. Kjo do të thotë se në këtë fazë, fëmija nuk ka nevojë të mësojë mbi konceptet që i lindin natyrshëm, por mbi elemente të teatrit që e plotësojnë krijimtarinë e tij, siç janë kostumet, skenografia, muzika, hijet, kukullat dhe elemente të tjera skenike që mund të përdorin për të shpërfaqur krijimtarinë e tyre. Kështu, fëmijët, përveçse zhvillojnë ndjenjën e përdorimit të imagjinatës e aftësive vetjake përmes përjetimeve konkrete interpretuese, fillojnë të zhvillojnë edhe aftësinë për ta shpjeguar pjesën skenike me fjalë të thjeshta.

Njohuritë

▪ Të besuarit në aktrim dhe improvizimi:

- Besimi tek loja;
- Besimi tek personazhi që i caktojnë;
- Improvizimi;
- Dëgjimi;
- Krijimi artistik i personazhit;
- Interpretimi në ansambël.



Shkathësitë

- dëgjon me vëmendje se çfarë thotë tjetri për të reaguuar sipas rrethanës dhe për t'iu përgjigjur me koherencë parafolësit, duke zhvilluar marrëdhënie të logjikshme shkak-pasojë;
- krijon individualisht duke konsideruar e respektuar të tjerët drejt një krijimi të përbashkët;
- zbulon aftësitë vetjake për të improvizuar dhe kupton se improvizimi është formë krijimi artistik;
- mëson për artin e të improvizuarit brenda një rrethane të caktuar.

8.2.2 Tematika: Teknika dhe procese teatrore

Përshkrimi i tematikës:

Në fazën e parashkollorit teknika e të besuarit në lojë është mjaft e lehtë për mësuesin, pasi fëmijëve kjo u lind natyrshëm (kujdes të mos i ndërjegjësoni ata mbi këtë besim, deri në përfundim të programit, sepse duke u folur për të mund të shkatërroni besimin e natyrshëm në detyrën e caktuar, duke i bërë të vetëkontrollohen, gjë që e kufizon krijimtarinë artistike dhe interpretuese). Por kjo nuk do të thotë se nuk ka mjaft vend për ta nxitur e pasuruar këtë besim, duke sjellë figura më të plota e me më shumë tipare artistike.

Kjo tematikë ndalet kryesisht në procesin e aktrimit të thjeshtë, besimit tek loja, improvizimit, dëgjimit, ndjekjes së procesit shkak-pasojë, por edhe me vlerësimin e interpretimit të tyre. Kjo tematikë mund të përfshijë interpretime të një pjese kombëtare, qofshin përralla, fabula, dramatizime apo rituale folklorike ose ndërkombëtare, si rrëfenja të njohura ose edhe pjesë të thjeshta dramaturgjike, specifike për këtë moshë, që mësuesi mund t'i marrë nga interneti. Nëpërmjet tyre ata hulumtojnë në terren të njohur, me gojëdhënat e ritualet e trashëguara nga folklori, por edhe me improvizime mbi përralla të njohura me maska, me kukulla, me hije, që janë shumë afër natyrës së lojërave të tyre me karaktere të



trilluara. Materialet duhet jenë didaktike me vlerë krijimi artistik, që edukojnë vlera të caktuara, ndaj tematika e tyre është e detyrueshme. Pjesët në këtë fazë duhet të jenë të thjeshta e të përshtatshme për moshën e fëmijëve.

Njohuritë

▪ **Lojë fëmijësh:**

- Pjesë të thjeshta me karaktere.
- Improvizim në grup me maska, me kukulla ose me hije me zgjedhje të lirë ose të përcaktuar kafshësh apo personazhesh të trilluara.
- Këngë popullore rituale me personazhe.

▪ **Rregullat e interpretimit:**

- Besimi në rol.
- Ruajtja e karakterit
- Karakteristika të personazhit
- Karakteristika të zhanrit
- Dëgjimi i kujdesshëm.
- Marrëdhënia shkak-pasojë.
- Shqiptimi.
- Interpretimi individual dhe në grup (kori).

▪ **Mjetet trupore:**



- Sjelljet fizike sipas personazhit.
- Komunikimi verbal sipas personazhit.
- Ndjekja e logjikës së personazhit.

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

- Imiton personazhin që i kanë caktuar ose që ka zgjedhur.
- Dëgjon dhe reagon sipas rrethanave.
- Zbulon aftësitë krijuese vetjake, duke eksperimentuar me improvizimin ose me përmbushjen e karakterit.
- Interpretin role të ndryshme.
- Kupton rregullat e interpretimit dhe zbaton disiplinën skenike.
- Shoqëron të tjerët në krijimin në ansambël.
- Interpretin duke u shprehur qartë e sipas personazhit.

8.2.3 Tematika: Historia, teatri dhe shoqëria

Përshkrimi i tematikës:



Ndërsa punon konkretisht me materiale të thjeshta, mëson dhe merr informacione mbi teatrin dhe veçanërisht mbi teatrot e kukullave, ndan përvojat që kanë përjetuar në frekuentimin e tyre ose gjatë ndjekjes së një teatri kukullash në televizor, çfarë u ka bërë përshtypje, si do ta kishin bërë ata vetë, flasin për elementet teatrore, si kostumet, maskat, skenografia, etj.

Kjo tematikë do të ndalet në koncepte fare të thjeshta të teatrit, me orientim mbi teatrin e kukullave që fëmijët e kanë më afër, duke zgjeruar ngadalë edhe njohuritë mbi teatrin mirëfilli si pema mëmë e teatrit të kukullave. Përmes pjesëve kombëtare dhe ritualit, fëmijët njihen me pasuri folklorike vendase, përmes improvizimit hulumtojnë më tej dhe përdorin dijet e tyre të marra nga një zhanër i njohur folklorik, siç janë përrallat e legjendat dhe sillen si personazhe që i kanë njohur nëpërmjet tyre. Këtu aplikohen edhe kostume historike kombëtare, fjalor popullor, të dhëna mbi lidhjet e para të shoqërisë së hershme shqiptare me format primitive teatrore, siç është rituali. Maskat, kukulla, hijet i ndihmojnë fëmijët në njohjen me maskat, hije, kukulla dhe rituale nëpër botë, funksionin e karakteristikat e elementeve pamore siç janë skenografia e kostumet etj.

Njohuritë

Skenografia / rekuizita, kostumet/ maskat: Skenografia dhe objektet skenike. Kostumet, Maskat, Kukullat, Hijet

Gjini të interpretimit: Përralla. Fabula. Teatri me maska. Teatri me kukulla. Teatri me hije. Komedia. Folklori.

Shkathësitë

Fëmija:

- mëson për rolin e skenografisë si element artistik që krijon atmosferë. Mëson për rolin dhe rëndësinë e objekteve skenike;
- mëson për rolin e kostumeve dhe të maskave në ritual dhe teatër;
- mëson për rrethanat historike që mund të përcillen nëpërmjet një kostumi, skenografisë apo elementeve skenike;
- merr informacione dhe shkëmben me mësuesin dije personale ndaj ritualit, përrallës, fabulës, dramatizimit dhe teatrit me kukulla;



- merr informacione mbi zhanre të teatrit me kukulla: teatri me maska, me kukulla, me hije, etj. dhe përdorimin e tyre edhe në teatrin mirëfilli;
- merr informacione mbi komedinë;
- merr informacione mbi krijimet folklorike me natyrë teatrore (ritualet);
- dallon gjinitë e shpjeguara dhe elementet që i karakterizojnë.

Qëndrime dhe vlera

- Paraqet kuriozitet për interpretimin, pjesët teatrore apo elementet skenike.
- Eksploron dhe zbulon elementet teatrore, duke shprehur mendimin e vet ndaj këtyre elementeve.
- Kupton karakteristikat e interpretimit.
- Shpreh idetë e veta për teatrin.
- Shprehet artistikisht për një pjesë teatrore.
- Demonstron vetëbesim në aktivitete të ndryshme artistike.
- Ka dëshirë për t'u shprehur dhe komunikuar në mënyrë të pavarur.
- Merr pjesë aktive në veprimtaritë teatrore vetëm dhe në grup.
- Përdor imagjinatën dhe krijimtarinë për të krijuar dhe interpretuar.
- Demonstron këmbëngulje dhe disiplinë skenike në krijimet teatrore.
- Bashkëpunon vetëm dhe me të tjerë në një veprimtari teatrore.
- Respekton diversitetin e kulturave të ndryshme.
- Tregon respekt për veten dhe të tjerët.
- Mban qëndrim ndaj veprave ose elementeve të caktuara teatrore.



- Njeh dhe respekton trashëgiminë kulturore kombëtare dhe trashëgiminë e kulturave të tjera.
- Demonstron frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë interpretimit apo krijimit teatror.
- Demonstron përqëndrim dhe durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese.

8.3 Materiale dhe burime mësimore

Gjatë mëimit të teatrit mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat fëmija i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon ambiente për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në këtë fushë duke ndihmuar fëmijët të eksplorojnë shfaqje, muzikë, metoda si të bëjnë diçka, elemente artistike, informacione për teatrin, materiale letrare, duke zhvilluar aftësitë e tyre teatrale. Mësuesi përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore dhe me një fjalor të pastër, por të thjeshtë të gjuhës teatrale. Mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai u prezanton/sqaron fëmijëve përmbajtjet e caktuara ose shkathtësitë që duhet të interpretojnë.

Teatri studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve si shikim të shfaqjeve, kërkimi për elemente të nevojshme, që kërkon shfrytëzimin e luajtësve të mediave të ndryshme, TV, pajisje digjitale si kompjuterët, etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Mjetet natyrore si:* vetë trupi i njeriut, zëri etj.
- *Mjetet audio-vizuale si:* TV, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- *Mjedisi mësimor si:* (klasa, studio pune, ambient interpretimi etj.).



PROGRAMI I KËRCIMIT

9.1 Hyrje

Kërcimi i lejon njerëzit të shprehin, të komunikojnë e të kuptojnë idetë dhe ndjenjat në një mënyrë të veçantë. Njohja me kërcimin është një vlerë e rëndësishme për të mundësuar zhvillimin e personalitetit të fëmijëve, zhvillimin e aftësive të tyre për të punuar në mënyrë të pavarur e sistematike, si dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike.

Një lidhje të ngushtë kërcimi e ka me artin e bukur të muzikës. Muzika nxit lëvizjen dhe lëvizja krijon ritmin. Shumëllojshmëritë e kërkesave dhe veprimtarive artistike të paraqitura në këtë program, udhëhiqen nga parimi, *muzika, lëvizja dhe bota e brendshme*. Njohja dhe zbatimi i përmbajtjeve në lëndën e kërcimit, sigurojnë mundësinë që fëmijët me anë të lëvizjeve dhe kërcimit, *të dëgjojnë, të lëvizin dhe të krijojnë*. Shpjegimi i lëvizjeve të kërcimit duhet bërë në formë të qartë dhe të kuptueshme.

Praktika mësimore duhet të ndërtohet në atë mënyrë që në kohën më minimale të japësh lëvizjet më të rëndësishme dhe më të përdorshme. Për këtë gjë duhet të ndiqet kalimi sistematik nga më të thjeshtat te më të vështirat. Me anë të kësaj praktike fëmija edukon te vetja guximin, durimin dhe përpjekjen për të kaluar të gjitha vështirësitë që hasin në ushtrime të ndryshme që nuk mund t'i realizojnë që në fillim në mënyrën e duhur.

Nga programi i kërcimit fëmija merr njohuri për *lëvizjen, hapësirën, ritmin, gjestin, motivin etj.* Gjatë krijimit të lirë të kërcimeve fëmijët zbulojnë pjesët e trupit dhe të veprimeve që kryejnë, njohin konceptet që lidhen me lëvizjen e trupit në hapësirë, bashkëveprimin e lëvizjeve në ritëm dhe nën tingujt e një muzike të dhënë vetëm, çift, në grup.



Kompetencat e lëndës:

Kompetenca 1: Krijimi nëpërmjet lëvizjeve

Kompetenca 2: Performimi/interpretimi i lëvizjeve dhe i kërcimeve

Kompetenca muzikore 3: Vlerësimi i lëvizjeve dhe i kërcimeve

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

- ***Krijimi nëpërmjet lëvizjes:*** fillon të kuptojë trupin, lëvizjet, gjuhën dhe rregullat elementarë të kërcimit dhe merr pjesë në procesin e krijimit të lëvizjeve, kërcimeve dhe lojërave kërcyese-muzikore.
- ***Performimi/interpretimi i lëvizjeve:*** performon kërcime të thjeshta dhe përqëndrohet gjatë interpretimit të kërcimit, realizon elemente të thjeshta të lëvizjeve teknike të përdorura në kërcim.
- ***Vlerësimi i lëvizjeve dhe kërcimeve:*** shpjegon me gjuhë të thjeshtë lëvizjet e përdorura gjatë një kërcimi; fillon të përdorë një fjalor shumë të thjeshtë të kërcimit për t'u shprehur në mënyrë artistike; shpjegon me fjalë të thjeshta mënyrën si e përjeton një vepër artistike

9.2 Përmbajtja e lëndës

Në programin e kërcimit për shkallën e parë janë paraqitur përmbajtjet e tematikave:

Gjuha dhe komunikimi i kërcimit

Teknika dhe procese të kërcimit



Historia, kërcimi dhe shoqëria.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas tematikave

9.2.1 Tematika : Gjuha dhe komunikimi i kërcimit

Përshkrimi i tematikës:

Kjo tematikë zhvillon kuptimin për elementet kryesore të kërcimit duke filluar me njohjen e trupit dhe lëvizjeve të ndryshme dhe të thjeshta të trupit (dorë, kokë, këmbët, trupi etj.) dhe kombinimet e tyre me muzikën. Përmes lëvizjeve zhvillohet ndjenja ritmike dhe melodike në bashkëveprim me lëvizjet e trupit, duke mundësuar kuptimin dhe shpjegimin e këtyre lëvizjeve me fjalë të thjeshta. Pas kuptimit të lëvizjeve ritmike dhe atyre trupore me hapa të thjeshtë, fëmija zhvillon intelegjencën kinetike duke u bërë i ndërgjegjshëm për aftësitë e veta krijuese në bazë të këtyre lëvizjeve. Procese të tilla si: përjetimi, dëgjimi, kërcimi apo krijimi përmes lëvizjeve trupore, ndihmon fëmijët të zhvillojnë jo vetëm komptencën e krijimit por edhe të zbatimit të këtyre lëvizjeve gjatë kërcimit apo kuptimin e elementeve teknike të kërcimit përmes njohjes konkrete dhe përdorimit të gjuhës së kërcimit në kërcime konkrete.

Njohuritë

▪ Lëvizjet e trupit

- Pozicioni i fillimit
- Pozicioni i përfundimit
- Lëvizjet e duarve, kokës, këmbëve në mënyrë të veçantë
- Hapat e thjeshtë
- Hapat në majë të gishtave (në gjysmë shputë)
- Vrapit i thjeshtë, vrapit me këmbët mbrapa, vrapit me këmbët përpara
- Uljet , ngritjet e trupit



- Kapërcimi
- Gjeste të ndryshme
- Figurat dhe format
 - **Muzika, hapësira, lëvizja dhe ritmi**
- Ritmi dhe lëvizja në muzikë
- Drejtimet përpara, mbrapa, majtas, djathtas
- Hapësira, lëvizjet shtrirë në tokë, lëvizjet në këmbë
 - **Marrëdhënia me partnerin**
- Pozicionet *përballë* me partnerin, *afër*, *pas njëri tjetrit*, *të kapur me një dorë*, *të kapur me dy duar*
- Veprimet e përbashkëta hapësinore: afrimi, qëndrimi së bashku, takimi etj.
- Koordinimi me partnerin me lëvizje të njëjta
- Lëvizja në rreth
- Lëvizja në të njëjtën kohë

Lëvizje teknike

- Mbajtja e trupit
- Zgjatja
- Mbajtja drejt e kokës



- Lëvizje të rrjedhshme të duarve

Shkathtësitë

Fëmija:

- demonstroi në mënyrën e duhur pozicionet fillestare dhe pozicionin e përfundimit të trupit;
- improvizon me *hapa* të ndryshëm, ritmin muzikor që dëgjon;
- dëgjon fragmente muzikore ose këngë për fëmijë dhe kupton shpejtësinë e ritmit, duke iu përgjigjur përmes lëvizjeve me *hapa normalë, hapave marsh, hapave të shpejtë, vrap etj.*;
- lëviz në përputhje me karakterin e muzikës me *hapa normalë, të shpejtë apo vrapimit të lehtë ose të shpejtë*;
- dëgjon dhe percepton *ritmin*, duke krijuar *figura* të thjeshta në hapësirë *rreth, në rresht (kolonë)*;
- krijon *figura të ndryshme në hapësirë* duke përdorur *hapat, vrapin* si psh: *rreth, kollona etj.*;
- demonstroi nëpërmjet *gjesteve dhe mimikës* përmbajtjen e një melodie të caktuar (*e gëzueshme, festive, e shpejtë, e hidhëruar*);
- improvizon në përshtatje me ritmin dhe melodinë, lëvizje të ndryshme trupore në hapësira të ndryshme;
- zhvillon *vëmendjen dhe kujtesën* për të mbajtur mend lëvizje të ndryshme që mëson;
- kërcen me partnerin duke respektuar lëvizjet *përballë me partnerin, afër, pas njëri tjetrit* (këngë dhe melodi të thjeshta për fëmijë);
- kërcen dhe shoqëron këngët në formën e lojës kërcyese - muzikore, duke ndërthurur muzikën me lëvizjet e përbashkëta *duke u afruar, larguar, duke krijuar rreth me hapa të thjeshtë* dhe në funksion të idesë;
- demonstroi karakteristikat e marrëdhënies me partnerin dhe lëvizjeve teknike: *mbajtja e trupit, zgjatja, mbajtja drejt e kokës, lëvizje të rrjedhshme të duarve.*



9.2.2 Tematika: Teknika dhe procese të kërcimit

Përshkrimi i Tematikës:

Pasi ka kuptuar njohuritë e para mbi trupin, lëvizjet e thjeshta të tij, ritmin, muzikën, elementet kryesore të kërcimit, në këtë tematikë ai fillon të zbatojë konkretisht, përmes teknikave dhe proceseve mësimore të kërcimit, këto njohuri mbi kërcimin. Proceset mësimore të kërcimit që zhvillohen në tërësi janë: kërcimi, lojrat kërcyese- muzikore, përjetimi, shikimi, improvizimi, krijimi, interpretimi.

Kryesisht kjo tematikë do të ndalet në procesin e kërcimit, interpretimit, lojrave kërcyese -muzikore, por edhe në interpretimin e tyre. Përmes interpretimit kjo tematikë ka si qëllim t'u mësojë nxënësve mënyrat e lëvizjes, mbajtjen e trupit, realizimin e elementeve kërcyese, realizimin e përmbajtjes koreografike. Mësimi i kërcimit mund të fillohet edhe nëpërmjet lojërave kërcyese - muzikore. Situatat dhe tematika e lojërave e bëjnë procesin mësimor më interesant dhe tërheqës, ku përpara nxënësve qëndrojnë detyrat muzikore, ritmike dhe kërcyese. Kështu, gjatë lojës nxënësit mëson për ritmin e muzikës, si dhe i realizon ato me hapa dhe kërcime të vogla sipas muzikës.

Njohuritë

- **Lojëra kërcyese - muzikore** të thjeshta për fëmijë
- **Mjetet trupore:**
 - duartrokitje të shuplakave,
 - duartrokitje të shuplakave mbi gjunjë,
 - përplasja e këmbëve,
 - përplasja e themrave



- **Marsh:**

- Hapat e thjeshtë të kërcimit; Marsh ² (hap me gjunjët lart); Hapat e marshit të shoqëruara me lëvizje të duarve

- **Vallja e pogonishtes:**

- Hapi i thjeshtë i Pogonishtes

- **Tre hapësh (hapi elementar i valsit)**

- Hapat e thjeshtuar të valsit
- Rrotullime të thjeshta me tre hapa

- **Rregullat e kërcimit**

- Mbajta e trupit drejt
- Mbatja e kokës
- Mbajtja e duarve
- Shtrirja

- **Kërcimi vetëm dhe me partner**

- Improvizon lojëra kërcyese për fëmijë, që shoqërohen me *hapa, lëvizje të thjeshta trupore, gjeste dhe mimikë.*

² Marsh i thjeshtë në kohën 2/4.



- Realizon lojërat kërcyese muzikore sipas një koreografie të caktuar të mbështetur në këngë për fëmijë.
- Shoqëron kërcimet e thjeshta me *mjete trupore* shuplaka, thembra, përplasje e këmbëve etj.
- Improvizon hapa të ndryshëm dhe përthyerje të ndryshme të trupit nën ritmin e muzikës, marsh në kohën 2/4.
- Kërcen *vetëm* dhe *me partner*.
- Kërcen dhe reagon gjatë ndryshimeve të ritmit apo karakterit muzikor nëpërmjet lëvizjeve të lira.
- Zhvillon lëvizje të pjesëve të ndryshme të trupit në hapësirë në sinkron me muzikën.
- Improvizon hapa të thjeshtë të kërcimit marsh, duke ndjekur ritmin dhe melodinë e muzikës: wedding marsh – F. Mendelson; Marshi turk- V.A.Moxart.
- Realizon fragmente shumë të shkurtra të kërcimit, duke përdorur *trupin* dhe *hapat* në mënyra të ndryshme: *duke rrëshkitur, duke kërcyer, duke lëvizur kokën në drejtime të ndryshme*, etj.
- Kryen *lëvizje të lira* sipas karakterit të muzikës që dëgjon në një hapësirë të caktuar.
- Demonstron *hapat e marshit* nën shoqërimin e muzikës.
- Demonstron *hapat e poganishtes* nën shoqërimin e muzikës.
- Demonstron hapat e thjeshtuar të valsit nën shoqërimin e muzikës
- Respekton *rregullat e kërcimit* gjatë kërcimeve të ndryshme *trupi, koka, duart, shtrirja e këmbëve*.

9.2.3 Tematika: Historia, kërcimi dhe shoqëria



Përshkrimi i Tematikës:

Zbulimi i njohurive të para mbi trupin, lëvizjet e tij, ritmin, muzikën dhe elementet e kërcimit, u jep mundësinë nxënësve të fillojnë të kuptojnë karakteristikat, të veçantat dhe të përbashkëtat që kanë kërcimet nga njëri- tjetrin.

Kuptojnë ndikimin e kërcimit në shoqëri. Përmes mësimi të hapave të tre kërcimeve shumë të thjeshta *marshit* apo valles folklorike *Pogonishtes* apo Valsit të thjeshtuar ata kuptojnë ndryshimet *ritmike, muzikore, lëvizore* midis tyre. Në të njëjtën kohë nxënësi kupton rolin që ka kërcimi në aktivitetet e ndryshe në shkollë dhe jashtë saj.

Njohuritë

Kërcimi dhe estetika

Shkathtësitë

Fëmija:

- kupton se kërcimi shprehet përmes lëvizjes dhe shpreh: *dashuri, keqardhje, gëzim,*

shpresë, mërzitje;

- komenton me fjalë të thjeshta kërcimet që shikon duke përdorur një fjalor të thjeshtë si: kërcim i bukur, më pëlqen etj.;
- shpjegon emocionin që i krijon lëvizja e ndërthurur me muzikën dhe ritmin në një kërcim të caktuar;
- shpreh emocionet për kërcimin që realizon apo përjeton;
- vlerëson performimin e shokut dhe të shoqes gjatë një improvizim/kërcimi të thjeshtë.



Qëndrime dhe vlera:

- Paraqet kuriozitet për lëvizjet e trupit në jetën e përditshme.
- Kërkon dhe zbulon lëvizje trupore që mund t'i realizojë me pjesë të ndryshme të trupit, duke shprehur mendimin e vet përmes këtyre lëvizjeve.
- Kupton ndikimin e ritmit dhe muzikës në shprehjen e lëvizjeve.
- Shpreh idetë e veta për kërcimin.
- Shprehet artistikisht për një kërcim.
- Demonstron vetëbesim në aktivitete të ndryshme artistike.
- Ka dëshirë për t'u shprehur dhe komunikuar në mënyrë të pavarur.
- Merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike vetëm dhe me partner.
- Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për të krijuar dhe interpretuar.
- Demonstron këmbëngulje në krijimet koreografike.
- Bashkëpunon vetëm dhe me të tjerë në një veprimtari artistike.
- Respekton diversitetin ndaj kulturave të ndryshme.
- Demonstron respekt për veten dhe të tjerët.
- Mban qëndrim ndaj kërcimeve si *marshit, pogonishte dhe lojërave kërcimore- muzikore*.
- Demonstron frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë kërcimit apo krijimit nëpërmjet lëvizjeve.
- Demonstron përqëndrim dhe durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese.



KOHA MËSIMORE SIPAS PROGRAMEVE LËNDORE

Plani mësimor realizohet në 35 javë mësimore. Në vitin përgatitor (mosha 5-6-vjeçare), kohëzgjatja e *kohës së mësimit* për një lëndë zgjat rreth 25-30 minuta. Mësimdhënia është e integruar dhe veprimtaritë ndjekin njëra-tjetrën, pa bërë ndarje fizike midis lëndëve dhe pa përcaktuar orar mësimor. Në secilën lëndë, sipas kompetencave/tematikave, është përcaktuar pesha e tyre, e cila synon ta orientojë mësuesin për shpërndarjen e ngarkesës në trajtimin e koncepteve lëndore. Shpërndarja e orëve ka për qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila kompetencë/tematikë në raport me orët totale vjetore.

Lënda: Gjuhë shqipe

Kompetencat/ orët	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Totali (orë)
Viti përgatitor	33	70	36	36	175

Lënda: Matematikë

Tematikat/orët	Numri	Matja	Gjeometria	Algjebra dhe funksioni	Statistika dhe probabiliteti	Totali (orë)
Viti përgatitor	106	12	12	7	3	140

Lënda: Dituri natyre



Tematikat/orët	Diversiteti	Ciklet	Ndërveprimi	Sistemet	Totali (orë)
Viti përgatitor	35	14	6	15	70

Lënda: Edukim për shoqërinë

Tematikat/orët	Individët, grupet, shoqëria	Kultura	Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia	Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve	Pushteti, autoriteti, qeverisja	Proceset shoqërore	Prodhimi, konsumi, shpërndarja	Totali (orë)
Viti përgatitor	20	10	10	5	10	5	10	70

Lënda: Edukim fizik, sporte dhe shëndet

Tematikat/orët	Edukim nëpërmjet aktiviteteve fizike	Lojëra parasportive	Edukim në shërbim të shëndetit, mirëqenies dhe komunitetit	Totali (orë)
Viti përgatitor	37	23	10	70 orë

Lënda: Muzikë

Tematikat/orët	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Teknika dhe procese	Historia, muzika dhe shoqëria	Totali (orë)
Viti përgatitor	10	20	5	35 orë



Lënda: Art pamor

Tematikat/orët	Gjuha dhe komunikimi artistik	Teknikat dhe procese	Historia, arti dhe shoqëria	Totali (orë)
Viti përgatitor	10	21	4	35 orë

Lënda: Teatër

Tematikat/orët	Gjuha dhe komunikimi teatror	Teknikat dhe proceset e interpretimit	Historia, teatri dhe shoqëria	Totali (orë)
Viti përgatitor	5	8	5	18 orë

Lënda: Kërcim

Tematikat/orët	Gjuha dhe komunikimi artistik	Teknikat dhe proceset	Historia, kërcimi dhe shoqëria	Totali (orë)
Viti përgatitor	5	10	2	1 orë

